



ZGJEDHJET LOKALE PA INSTITUCIONE QENDRORE, KRYEZIU ALARMON SE KOSOVA PO HYN NË NJË DEGRADIM INSTITUCIONAL



Drejtori i Institutit Demokratik të Kosovës (KDI), Ismet Kryeziu, ka thënë se ekziston rreziku që vendi të mbetet pa asnjë nivel funksional qeverisës edhe në nivelin lokal

dhe në atë qendror. "Kjo është një situatë alarmante dhe e papranueshme: një shtet i tëri në pauzë dhe jofunksional. Në vend të konsolidimit të institucioneve, po përballemi

me rrezikun real të hyrjes në një spirale degradimi institucional - pa përgjegjësi politike, pa përfaqësim qytetar dhe pa besim publik", ka thënë Kryeziu

**FSK-ja REALIZON
DITËN E VIZITORËVE
TË SHQUAR
TË USHTRIMIT
"DEFENDER
EUROPE 25"**



**'RASTET NË RITJE'.
PSE STATISTIKAT
PËR INFEKSIONET
SEKSUALISHT
TË TRANSMETUESHME
THONË TË
KUNDËRTËN?**



**DËSHIMI I HEKURUDHËS: KOSTO
TË LARTA, REZULTATE TË PAKTA**

DOSSIER



**LUFTËTARËT E MËDHENJ BIEN NË
BETEJËN E FUNDIT**

SPORT

**RAÇI DHE RRUDHANI, OPTIMISTË PËR
FITORE NË DY NDESHJET MIQËSORE**

RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.PK.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBANJIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Qeveria holandeze rrëzohet pas përplasjes për politikën e migracionit

AMSTERDAM, 3 QERSHOR - Koalicioni qeverisës në Holandë u rrëzua të martën pasi Geert Wilders, lideri i ekstremit të djathtë dhe kreu i Partisë për Liri (PVV), vendosi ta tërhiqte partinë e tij nga qeveria për shkak të mosmarrëveshjeve të thella mbi politikën e migracionit. Wilders, i cili doli fitues në zgjedhjet e nëntorit 2023 dhe udhëheq partinë më të madhe në parlament, kishte paralajmëruar që në fund të majit se do të shkaktonte rënien e qeverisë nëse nuk zbatohet brenda disa javësh plani i tij dhjetë pikësh për kufizimin e imigracionit. Plani i Wilders përfshinte mbylljen e kufijve për

azilkërkuesit, ndalimin e bashkimit familjar për refugjatët e njohur, mbylljen e qendrave të azilit, forcimin e kontrolleve kufitare dhe dëbimin e shtetasve me nënshtetësi të dyfishtë që janë dënuar për vepra penale. Megjithatë, një numër ekspertësh politikë dhe ligjorë e cilësuan këtë plan si të pazbatueshëm dhe të paligjshëm, ndërsa disa vlerësuan se Wilders e kishte krijuar vetë krizën me qëllim rrëzimin e qeverisë dhe organizimin e zgjedhjeve të reja. Pas bisedimesh të shkurtra dhe të tensionuara të martën në mëngjes mes katër partive të koalicionit, Wilders deklaroi se e kishte informuar



kryeministrin se PVV-ja do të tërhiqej nga qeveria dhe se nuk mund të mbante më përgjegjësi për këtë kabinet. Ai theksoi se kishte hyrë në koalicionin për ta realizuar politikën më të ashpër për azilin dhe jo për "rrënimin e Holandës". Tërheqja e PVV-së i jep fund një qeverisjeje që nga fillimi ishte e brishtë dhe pritet të çojë në zgjedhje të parakohshme, duke e futur vendin në një periudhë të re pasigurie politike. Në të gjithë Evropën forcat e ekstremit të djathtë po përjetojnë rritje, ndërsa Holanda përgatitet të presë një samit të rëndësishëm të NATO-s.

Tërmet në Turqi: Një e mitur humbet jetën, dhjetëra të lënduar nga paniku

MARMARIS, 3 QERSHOR - Një tërmet me magnitudë 5.8 goditi në orët e para të së martës një zonë bregdetare të Turqisë, duke shkaktuar panik te banorët. Dhjetëra persona u lënduan pasi u hodhën nga ballkonet dhe dritaret për të shpëtuar, ndërsa një vajzë 14 vjeçe ndërroi jetë pasi u dërgua në spital.

Autoritetet nuk raportojnë për dëme të konsiderueshme materiale.

Agjencia për Menaxhimin e Fatkeqësive dhe Emergjencave bëri me dije se tërmeti ndodhi në orën 02:17 të mëngjesit dhe kishte epiqendrën në Detin Mesdhe, pranë qytetit turistik



Marmaris.

Lëkundjet u ndien edhe në

rajone përreth, përfshirë

ishullin grek Rodos, duke zgjuar

banorët nga gjumi.

Ministri i Brendshëm turk, Ali Yerlikaya, njoftoi se 14 vjeçja vdiq në spital si pasojë e një krize ankthi. Nuk dihet nëse ajo vuante nga ndonjë sëmundje paraprake. Ai shtoi se rreth 70 persona të tjerë janë lënduar duke u hedhur nga lartësitë për shkak të frikës. Nuk janë raportuar dëmtime në ndërtesa.

Në ishullin Rodos banorët dhe turistët kaluan disa orë jashtë banesave e hoteleve, por autoritetet greke thanë se dëmet ishin të vogla.

Sipas Efthymios Lekkas, drejtues i Organizatës Greke për Planifikim dhe Mbrojtje nga

Tërmetet, epiqendra ishte në një thellësi prej 60 kilometrash, gjë që shpjegon pse nuk pati pasoja të mëdha në sipërfaqe. "Edhe pse u ndje në një zonë të gjerë, nuk pritet të ketë ndikim serioz në terren", tha ai për televizionin shtetëror grek. Turqia ndodhet në një zonë me rrezik të lartë sizmik dhe lëkundjet janë të shpeshta. Në shkurt të vitit 2023 një tërmet katastrofik me magnitudë 7.8 shkaktoi mbi 53 mijë viktima në Turqi dhe shkatërroi ose dëmtoi rëndë mijëra ndërtesa në 11 provinca jugore. Në Siri humbën jetën edhe rreth 6 000 persona të tjerë.

Annalena Baerbock zgjidhet presidente e Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së

NJU-JORK, 3 QERSHOR - Ish-ministrja e Jashtme e Gjermanisë, Annalena Baerbock, është zgjedhur presidente e Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara me shumicë votash në Nju-Jork.

Përmes një votimi të fshehtë, të mbajtur në këtë institucion - më të madhin të Kombeve të Bashkuara - Baerbock, 44-vjeçare, ka siguruar 167 vota, 14 anëtarë kanë abstenuar, ndërsa shtatë të tjerë kanë votuar për kandidaten tjetër.

Zgjedhja e saj në seancën plenare para 193 vendeve anëtare të OKB-së është konsideruar formalitet, mirëpo

votimi sekret është mbajtur, siç është raportuar, me kërkesë të Rusisë.

Në fjalimin e saj, Baerbock ka thënë se dëshiron të udhëheqë këtë institucion si "ndërmjetëse e sinqertë dhe unifikuese". "Dera ime do të jetë gjithmonë e hapur për secilin", ka thënë ajo.

Duke iu referuar krizave të shumta në botë, ajo ka thënë se "po jetojmë në kohë sfiduese, dhe jemi duke ecur në një litar të tendosur të pasigurisë". "Por, ne kemi jetuar edhe më parë nëpër këso periudha të vështira. Na përket neve që të merremi me këto sfida".

Baerbock pritet të inaugurohet



më 9 shtator, pak para nisjes së seancës vjetore të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara. Kjo pozitë njëvjeçare është kryesisht ceremoniale dhe nuk duhet të ngatërrohet me rolin e sekretarit të përgjithshëm të OKB-së, Antonio Guterres.

Guterres ka shprehur mbështetje të plotë për Baerbockun, duke përmendur përvojën e saj si ministre e Jashtme e Gjermanisë. "Le të mos harrojmë rëndësinë historike që ajo është vetëm gruaja e pestë që zgjidhet presidente e Asamblesë së Përgjithshme", ka thënë mes tjerash Guterres.

OSMANI I FTON PARTITË PËR KONSULTIM RRETH DATËS SË ZGJEDHJEVE LOKALE

PRISHTINË, 3 QERSHOR - Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, i ka ftuar subjektet politike për një takim të mërkurën, për t'u konsultuar rreth datës së zgjedhjeve lokale në Kosovë. “Menjëherë pas konsultimeve, presidentja do ta caktojë datën e zgjedhjeve”, ka bërë me dije Bekim Kupina, këshilltar për medie i presidentes Osmani. Zgjedhjet e fundit lokale në Kosovë janë mbajtur në tetor të vitit 2021. Lidhja Demokratike e Kosovës pati dalë e para, e pasuar nga Lëvizja Vetëvendosje dhe Partia Demokratike e Kosovës. Diskutimet për zgjedhjet lokale bëhen në kohën kur Kosova ende nuk ka qeveri të re si pasojë e moskonstituimit të Kuvendit të Kosovës, ndonëse zgjedhjet parlamentare janë mbajtur më 9 shkurt të këtij viti.

Më 2 qershor Kuvendi ka dështuar të konstituohet për të 25-n herë. Lëvizja Vetëvendosje, që ka fituar më së shumti vota në zgjedhjet e 9 shkurtit, dhe partitë që në legjislaturën e kaluar ishin në opozitë, nuk kanë arritur pajtueshmëri për mënyrën e votimit për kreun e ri të parlamentit, dhe për propozimin e LV-së për këtë pozitë, Albulena Haxhiun, duke e konsideruar figurë përçarëse. Deputetët duhet ta zgjedhin kryetarin dhe pesë nënkryetarët për ta konstituuar përfundimisht Kuvendin e ri. Vetëm pas konstituimit të Kuvendit mund të formohet qeveria e re. Përfaqësuesit diplomatikë të shteteve të Quint-it [Shteteve të Bashkuara, Britanisë së Madhe, Italisë, Francës dhe Gjermanisë] si dhe shefi i Zyrës



së Bashkimit Evropian në Kosovë janë takuar ditë më parë me kryeministrin në detyrë të Kosovës, Albin Kurti, duke kërkuar formim të shpejtë të institucioneve, për të siguruar mirëqenien dhe prosperitetin e qytetarëve të Kosovës.

ZENUN ELEZAJ DHE BALI MUHARREMAJ, SËRISH KANDIDATË PËR KRYETAR NË ZGJEDHJET LOKALE

PRISHTINË, 3 QERSHOR - Kryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Ramush Haradinaj, ka bërë me dije se Zenun Elezaj do të jetë sërish kandidat për kryetar komune i Klinës dhe Bali Muharremaj kandidat për kryetar të Suharekës. “Për kohën që iu dha besimi Aleancës për ta qeverisur Klinën, në krye me prof. Zenun Elezaj, kësaj komune i ofruam një qeverisje për t'u marrë shembull, që shpeshherë është përmendur si model edhe nga qytetet e tjera. Kryetari, prof. Zenun Elezaj, me ekipin e tij të përkushtuar, i ka dhënë shtytje të jashtëzakonshme zhvillimit dhe përparimit të komunës. Pikërisht sot, në 25-vjetorin e themelimit të Aleancës në Klinë, Këshilli i Përgjithshëm i Degës ka propozuar kryetarin Elezaj për një mandat të ri katërvjeçar në krye të komunës, një vendim i natyrshëm për të vazhduar punën dhe vizionin që ka dëshmuar rezultate konkrete. E njëjta frymë



qeverisëse është ndërtuar edhe në Suharekë, ku nën udhëheqjen e Bali Muharremajt, qytetarët kanë përjetuar një transformim të dukshëm në shërbime, infrastrukturë dhe zhvillim të përgjithshëm. Po

ashtu, sot, Këshilli i Përgjithshëm i Degës së Aleancës në Suharekë ka propozuar Kryetarin Muharremaj për një mandat të ri katërvjeçar, si vazhdimësi e një liderशिpi që ka dëshmuar përgjegjësi dhe suksese gjatë



qeverisjes, që na ka bërë krenarë të gjithëve”, ka thënë Haradinaj. Ai ka thënë se komunat ku udhëheq Aleanca janë dëshmuar si lidere të qeverisjes së mirë, të ndershme dhe të përgjegjshme. “Kjo traditë do të vazhdojë jo

vetëm aty ku tashmë qeverisim, por edhe në komunat e tjera ku qeverisja jonë po shihet gjithnjë e më shumë si zgjedhja e duhur për zhvillim”, është shprehur lideri i AAK-së, Ramush Haradinaj.

Besa Shahini shpall kandidaturën për kryetare të Prishtinës

PRISHTINË, 3 QERSHOR - Ish-ministria e Arsimit në Shqipëri, Besa Shahini, ka njoftuar se do të kandidojë për kryetare të Prishtinës në zgjedhjet lokale të këtij viti. Lajmin e ka dhënë vetë Shahini në rrjetin social “Facebook”. “Para katër viteve jam kthyer të jetoj në

Prishtinë nga Tirana, në një qytet që e dua fortë, që ka një potencial të jashtëzakonshëm, i cili ka marrë një kahje të gabuar në zhvillimin e vet. Është një qytet kryesisht i mbuluar me beton, pa hapësira të mjaftueshme të gjelbërta, kryesisht i papastër, edhe jo

shumë miqësor për fëmijët. Prishtinës i duhet një ndryshim radikal në kahjen e zhvillimit. Unë dua të jem pjesë e këtij ndryshimi, ndaj në vjeshtë do të garojë për kryetare të komunës në zgjedhjet lokale 2025”, ka thënë Shahini në një videoadresim.





ZGJEDHJET LOKALE PA INSTITUCIONE QENDRORE, KRYEZIU ALARMON SE KOSOVA PO HYN NË NJË DEGRADIM INSTITUCIONAL

Drejtori i Institutit Demokratik të Kosovës (KDI), Ismet Kryeziu, ka thënë se ekziston rreziku që vendi të mbetet pa asnjë nivel funksional qeverisës edhe në nivelin lokal dhe në atë qendror. “Kjo është një situatë alarmante dhe e papranueshme: një shtet i tëri në pauzë dhe jofunksional. Në vend të konsolidimit të institucioneve, po përballemi me rrezikun real të hyrjes në një spirale degradimi institucional - pa përgjegjësi politike, pa përfaqësim qytetar dhe pa besim publik”, ka thënë Kryeziu.

EPOKA E RE

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 3 QERSHOR - Drejtori i Institutit Demokratik të Kosovës (KDI), Ismet Kryeziu, ka thënë se ekziston rreziku që vendi të mbetet pa asnjë nivel funksional qeverisës, edhe në nivelin lokal dhe në atë qendror, marrë parasysh që aktualisht Kosova s'ka institucione të reja dhe po pritët që të caktohet data e zgjedhjeve lokale. “Qytetarët janë të lodhur dhe pothuajse tërësisht të dorëzuar përballë një klase politike të papërgjegjshme, e cila betejën për pushtet po e ndjek përmes bllokadës institucionale. Institucionet janë kthyer në treg paqazi dhe në kauza të ngushta individuale e partiake - jo në zgjidhje dhe shërbim për qytetarët. Jemi gati një vit pas shpalljes së zgjedhjeve parlamentare dhe ende pa Kuvend e Qeveri funksionale. Ndërkohë, po afrohet koha e

zgjedhjeve të rregullta lokale”, ka shkruar Kryeziu në “Facebook”.

Ai ka thënë se në këtë situatë ekziston rreziku real që vendi të mbetet pa asnjë nivel funksional të qeverisjes - as në nivelin lokal, as në atë qendror. “Kjo është një situatë alarmante dhe e papranueshme: një shtet i tëri në pauzë dhe jofunksional. Në vend të konsolidimit të institucioneve, po përballemi me rrezikun real të hyrjes në një spirale degradimi institucional - pa përgjegjësi politike, pa përfaqësim qytetar dhe pa besim publik. Kjo nuk është më thjesht një krizë politike - është krizë e demokracisë, e përfaqësimit dhe e shtetndërtimit. Si qytetarë, nuk i kemi asnjë borxh askujt të abuzon me vullnetin tonë apo të sillet me shtetin si me pronën e vet private”, ka theksuar Kryeziu.

Të hënën ka dështuar sërish konstituimi i Kuvendit të

Kosovës edhe në tentativën e 25, pasi sërish nuk pati vota të mjaftueshme për formimin e Komisionit për Votim të Fshehtë për zgjedhjen e kryeparlamentarit. Nga 104 deputetë që ishin në sallë, 51 deputetë votuan për, një kundër dhe s'pati abstencionim. Kryesuesi i seancës, Avni Dehari, ka njoftuar se seanca ndërpritet për shkak të mungesës së kuorumit dhe do të vazhdojë më 4 qershor në orën 10:30.

Çështja e votimit të fshehtë - që u propozua më 1 maj nga kryesuesi i seancës, Avni Dehari, pasi e propozuara e Lëvizjes Vetëvendosje (LV) për kryetare të Kuvendit, Albulena Haxhiu, nuk arriti në disa votime t'i merrte 61 votat e nevojshme për t'u konfirmuar në post - është dërguar në Gjykatën Kushtetuese të Kosovës nga partitë që në legjislaturën e kaluar ishin në opozitë. Ato thonë se është jokushtetuese mënyra se si LV-ja po tenton që

kryeparlamentari të votohet përmes formës së fshehtë dhe i kanë kërkuar Kushtetueses të marrë “një masë të përkohshme për ndalim të mbajtjes së seancave, derisa me prioritet ta trajtojë këtë lëndë dhe ta marrë një vendim”.

Partia Demokratike e Kosovës (PDK), Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) dhe Lista Serbe refuzuan sërish, në vazhdimin e seancës konstituive më 2 qershor, ta propozonin një përfaqësues që do ta siguronte mbarëvajtjen e votimit të fshehtë.

Deri më tani deputetët kanë kaluar vetëm dy pika të agjendës së seancës konstituive: raportin e Komisionit të Përkohshëm për Verifikimin e Mandateve dhe atë të Betimit të Deputetëve. Procesi ka ngecur te pika e tretë: zgjedhja e kryeparlamentarit. Haxhiu e LV-së po konsiderohet figurë përçarëse nga dy parti parlamentare: PDK-ja dhe AAK-ja. Këto dy subjekte kanë kërkuar që LV-ja të nxjerrë emër tjetër për kryeparlamentar. LDK-ja, ndërkaq, ka thënë se nuk ka vota për asnjë të propozuar të LV-së për pozitën e kryeparlamentarit.

Propozimi për kryeparlamentar është e drejtë ekskluzive e fitueses së zgjedhjeve, LV-së, e cila ngul këmbë se Haxhiu e meriton të zgjidhet dhe,

ndonëse ka kërkuar marrëveshje politike me partitë e tjera, e ka përjashtuar mundësinë të sjellë kandidat tjetër pos saj.

Deputetët duhet ta zgjedhin kryetarin dhe pesë nënkryetarët për ta konstituuar përfundimisht Kuvendin e ri.

Vetëm pas konstituimit të Kuvendit mund të formohet qeveria e re.

Ministria në detyrë, njëherësh kandidate për kryeparlamentare, Albulena Haxhiu, ka folur pas dështimit të konstituimit të Kuvendit të Kosovës më 2 qershor. Ajo para medieve ka thënë se partitë opozitare me një inat irracional kanë vendosur të mos marrin pjesë në votim.

Deputetja e PDK-së, Vlora Çitaku, ka thënë se vendi është në një fazë të rrezikshme. “Kemi hyrë në një fazë të rrezikshme për vendin. Ekonomia po dëmtohet dhe po rrezikohet. 140 mijë punëtorë po rrezikohen, familjet tona po rrezikohen e në ndërkohë Kuvendi dhe institucionet vazhdojnë të mbesin të bllokuara për shkak të kryeneçësisë së grupit të parë parlamentar”, ka thënë Çitaku. Deputeti i LDK-së, Lufti Haziri, ka thënë se situata është e njëjtë dhe se mungesa e një vullneti politik për të gjetur një zgjidhje të shpejtë politike është bërë e pavlefshme për ta përmendur.

Radoniqi pret në takim ambasadorin e Turqisë, flasin për zgjedhjet lokale

PRISHTINË, 3 QERSHOR - Kryesuesi i KQZ-së, Kreshnik Radoniqi, ka pritët të martën në takim ambasadorin e Turqisë në Kosovë, Tunç Angli.

Në këtë takim, Radoniqi e njoftoi ambasadorin turk lidhur për angazhimet aktuale të KQZ-së të cilat ndërlidhen me procesin parapërgatitor

për organizimin e zgjedhjeve lokale të cilat do të mbahen gjatë këtij viti.

Ndërkaq ambasadori Angli shprehu gatishmërinë e

ambasadës turke për ta mbështetur Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

Po në këtë takim u diskutua edhe për mundësinë e

bashkëpunimit në fushën e zgjedhjeve ndërmjet KQZ-së së Republikës së Kosovës me institucionet e Republikës së Turqisë.

“RASTET NË RRIJTJE”. PSE STATISTIKAT PËR INFEKSIONET SEKSUALISHT TË TRANSMETUESHME THONË TË KUNDËRTËN?

PRISHTINË, 3 QERSHOR - Statistikat thonë se në Kosovë ka gjithnjë e më pak persona me infeksione seksualisht të transmetueshme. Por, e vërteta qëndron ndryshe, pasi që statistikat nuk e pasqyrojnë realitetin. Këtë e thekson vetë shefi i Repartit për Sëmundjet Seksualisht të Transmetueshme në Klinikën Infektive të Qendrës Klinike Universitare të Kosovës, Murat Mehmeti. “Nuk mund të flitet për rënie të numrit të rasteve të reja. Përkundrazi, mendoj se ka rritje të tyre”, thotë Mehmeti për Radion Evropë e Lirë.

Por, pse statistikat thonë të kundërtën?

Një raport për profilin gjinor të Kosovës, i publikuar në nëntor të vitit 2024 dhe i financuar nga Bashkimi Evropian, thotë se arsyeja kryesore është se shumica e këtyre rasteve diagnostikohen në laboratorë privatë, që nuk i raportojnë ato në Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike në Kosovë (IKShPK).

Në një përgjigje për REL-in, IKShPK-ja tregon se, ligjërisht, të gjitha institucionet shëndetësore, qofshin ato private apo publike, janë të detyruara t'i raportojnë këto raste. Madje, Ligji përkatës për Parandalimin dhe Kontrollin e Sëmundjeve Ngjithëse parasheh edhe afatin kohor, brenda të cilit duhet të bëhet raportimi. Shumë prej infeksioneve duhet të raportohen brenda 24 orëve.

Çfarë janë infeksionet seksualisht të transmetueshme?

Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSH) i definon këto infeksione si ato që përhapen kryesisht përmes kontakteve seksuale pa mbrojtje. Nëse nuk trajtohen,

sipas OBSH-së, “ato mund të çojnë në pasoja serioze, përfshirë sëmundje neurologjike dhe kardiovaskulare, infertilitet, shtatzëni jashtë mitre dhe rritje të rrezikut për infektim me Virusin e Imunodeficiencës Njerëzore (HIV)”. Edhe pse shumica e infeksioneve të tilla nuk shfaqin simptoma, disa sinjale për to mund të jenë rrjedhjet e pazakonshme nga vagina, ulçeret gjenitale dhe dhimbja në pjesën e poshtme të barkut.

Pse duhet të raportohen?

Për Mehmetin dukuria e mosraportimit të këtyre rasteve është shqetësuese. “Është shumë e rëndësishme të dihet numri i rasteve të të

infektuarve, në mënyrë që të parandalohet shpërndarja dhe të trajtohen ata të infektuar. Duke u trajtuar dhe raportuar, zvogëlohet mundësia e transmetimit të personat e tjerë”, thotë Mehmeti. Në bazë të statistikave ekzistuese nga rastet që raportohen, mbi 60 për qind e të infektuarve në Kosovë janë gra. Shumica i takojnë grup-moshës nga 25 deri në 49 vjeç dhe numri më i madh i të infektuarve është nga Peja, Prishtina dhe Ferizaj. Mehmeti thotë se Klinika Infektive në QKUK ka mjaftueshëm staf e barna për t'i trajtuar këto raste, por se, prapëseprapë, shumica e tyre drejtohen për në institucione private të kujdesit shëndetësor. Rol të madh luajnë paragjykimet në shoqëri për

personat me këto infeksione, që, sipas Mehmetit, ekzistojnë ende, edhe pse në nivele më të ulëta sesa më parë. “Ata ndihen më rehat nëse shkojnë në ndonjë klinikë private, sepse mundësia e takimit me më shumë njerëz është më e vogël dhe privatësia padyshim që është më e madhe”, thotë ai. Sipas raportit për profilin gjinor të Kosovës të vitit 2024, një tjetër faktor që ka sjellë uljen e këtyre rasteve, janë ndryshimet në atë se çka cilësohet infektion seksualisht i transmetueshëm e çka jo. IKShPK-ja thotë për REL-in se lista e këtyre infeksioneve është përditësuar në përputhje me “protokollet dhe udhëzimet e agjencive ndërkombëtare, si Qendra Evropiane për Parandalimin dhe Kontrollin e

Sëmundjeve (ECDC) dhe OBSH-ja”, pa treguar se çfarë ndryshimesh janë bërë. Aktualisht, IKShPK-ja liston gjashtë lloje të infeksioneve seksualisht të transmetueshme. Më të shpeshtat janë: condyloma acuminata dhe chlamydia trachomatis. Në mesin e këtyre infeksioneve nuk hyn virusi HIV që shkakton sëmundjen AIDS, e që është gjithashtu seksualisht e transmetueshme. Për dallim nga infeksionet e tjera, personat e infektuar me virusin HIV mund të gjejnë trajtim vetëm në Klinikën Infektive në QKUK. Numri i rasteve të reja është rritur dukshëm viteve të fundit, ndërsa deri më tani këtë vit janë identifikuar edhe shtatë raste të tjera.



Kryetari i AGK-së bëhet pjesë e bordit të Federatës Evropiane të Gazetarëve

PRISHTINË, 3 QERSHOR - Në Kongresin Zgjedhor të Federatës Evropiane të Gazetarëve (EFJ), i mbajtur më 2-3 qershor 2025 në Budapest, për herë të parë në historinë e EFJ-së, një përfaqësues i Asociacionit të Gazetarëve të Kosovës është zgjedhur anëtar i Bordit Drejtues të kësaj organizate. Kryetari i Bordit të AGK-së, Xhemajl Rexha, u zgjodh në këtë pozicion të rëndësishëm, duke shënuar një moment historik të rëndësishëm për përfaqësimin e gazetarëve të Kosovës në nivel evropian.

Zgjedhja e Xhemajl Rexhës në Bordin Drejtues të EFJ-së përfaqëson një njohje të rëndësishme për punën e AGK-së për mbrojtjen e të drejtave të gazetarëve dhe promovimin e lirisë së shtypit në Kosovë. Ky zhvillim forcon zërin e gazetarëve të Kosovës dhe rajonit në arenën evropiane dhe hap rrugë për bashkëpunime të reja në mbrojtje të standardeve profesionale dhe etike në gazetari.

Kjo ishte hera e parë që EFJ mbajti një takim statutor në Hungari, duke mbledhur mbi 120 gazetarë dhe përfaqësues



sindikalë nga 38 vende evropiane. Në këtë takim u zgjodhën 7 nga 11 kandidatët

për anëtarë të Komitetit Drejtues për një mandat trevjeçar, si dhe u zgjodhën

presidentja Maja Server dhe nënkryetari i ri i EFJ-së, Pablo Auiquel Garbarini (SNJ-CGT, Francë). Përpos Rexhës, anëtarë të tjerë të Bordit Drejtues të EFJ-së janë: Andrea Roth (DJV, Gjermani), Allan Boye Thulstrup (DJ, Danimarkë), Renske Heddema (NJV, Holandë), Antonis Repanas (ESIEMTH, Greqi), Aise Banu Tuna (TGS, Turqi) dhe Sergiy Tomilenko (NUJU, Ukrainë). Bordi Drejtues i EFJ-së është organi më i lartë ekzekutiv i organizatës që mbledh rreth 300 mijë anëtarë nga i gjithë kontinenti.

FSK-ja REALIZON DITËN E VIZITORËVE TË SHQUAR TË USHTRIMIT “DEFENDER EUROPE 25”

PRISHTINË, 3 QERSHOR - Në prani të udhëheqësve më të lartë shtetërorë, përfaqësuesve diplomatikë dhe udhëheqës të lartë ushtarakë ndërkombëtarë, Forca e Sigurisë së Kosovës realizoi Ditën e Vizitorëve të Shquar të ushtrimit fushor shumëkombësh “Defender Europe 25” (DE/IR25). Fillimisht ata u pritën nga Komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës, gjenerallejtënant Bashkim Jashari, në Aeroportin e Gjakovës dhe së bashku vizituan Post-Komandën Taktike të Divizionit të 28 të Ushtrisë Amerikane. Ata u njohën nga afër me zhvillimet e aktiviteteve prej komandës së ushtrimit në rajonin e Ballkani Perëndimor, përkatësisht të forcave të angazhuara në Shqipëri, Maqedoni të Veriut, Bullgari, Mal të Zi, Greqi dhe ato në Kosovë. Gjatë vizitës në Kontrollin e Lartë të Ushtrimit, personalitetet e larta u njohën nga afër me rolin e rëndësishëm dhe kontributin e

Forcës së Sigurisë së Kosovës si nikoqir në kuadër të këtij ushtrimit, duke vlerësuar lart bashkëpunimin e ngushtë dhe të frytshëm me Divizionin e 28 të Ushtrisë Amerikane. Përveç realizimit të aktiviteteve sipas skenarit të ushtrimit, trupat tona kanë ofruar mbështetje reale dhe logjistike për të gjitha trupat e angazhuara në vendin tonë. Me një profesionalizëm të lartë, Komanda e Forcës Tokësore dhe njësitë e tjera të angazhuara demonstuan nivel të lartë profesional dhe të disiplinës në ekzekutimin e disa prej aktiviteteve të parapara në poligonin trajnues të Babaj Bokës. Gjatë realizimit të demonstrimeve nga Regjimenti i Dytë i Këmbësorisë të FSK-së dhe njësitë ndërkombëtare, ata shfaqën nivel të lartë të disiplinës gjatë ekzekutimit të operacioneve të përbashkëta me forcat aleate të angazhuara në këtë ushtrim duke dëshmuar



ndërveprueshmëri të lartë. UF Defender Europe 25 është seria e ushtrimeve të përbashkëta që luan një rol strategjik në promovimin e sigurisë dhe stabilitetit, duke përfshirë forcat nga vende të NATO-s dhe ato partnere. Në përmbyllje, personalitetet e larta i përgëzuan ushtarakët e FSK-së dhe ata ndërkombëtarë

për përkushtimin, profesionalizmin dhe bashkëpunimin e shkëlqyer gjatë këtij ushtrimi shumëkombësh. Kësaj radhe Kosova pati një rol kyç pasi që mirëpriti Divizionin Komandues Amerikan të brigadave të shteteve të tjera në Ballkanin Perëndimor dhe më gjerë. Ata vlerësuan se realizimi i UF

“Defender Europe 25” në këtë nivel është një mundësi e shkëlqyer për avancimin e kapaciteteve operacionale të FSK-së në ndërveprueshmëri me aleatët dhe partnerët. Stërvitje të tilla përpos që rrisin bashkëpunimin me forcat mike ato, mbi të gjitha, rrisin gatishmërisë e forcave tona për përmbushje të misionit.

PËR HERË TË PARË NË SHSKUK KA FILLUAR TRAJTIMI ME METODËN MODERNE VNS PËR PACIENTËT ME EPILEPSI FARMAKOREZISTENTE

EPOKA E RE **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 3 QERSHOR - Në Shërbimin Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës (ShSKUK) për herë të parë ka filluar të ofrohet trajtimi me metodën moderne të Elektrostimulimit të Nervit Vagus (VNS) për pacientët me epilepsi farmakorezistente. Në bashkëpunim me Klinikën e Neurokirurgjisë dhe me mbështetjen e Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës (ShSKUK) janë siguruar pajisjet dhe janë përmbushur të gjitha parakushtet për realizimin e këtij trajtimi. Më 2 dhe 3 qershor 2025 janë



trajtuar me sukses tre pacientët e parë, të përzgjedhur nga ekipi multidisciplinar i Klinikës së Neurologjisë, të cilët kanë përmbushur kriteret për implantim.

Ndërhyrja kirurgjike është realizuar në sallën e operacionit të Klinikës së Neurokirurgjisë nën udhëheqjen e neurokirurgut të njohur nga Italia, dr. Leonardo Fiori (Ospedale di Lecco

“Alessandro Manzoni”), në bashkëpunim me neurokirurgët e udhëhequr nga dr. Besnik Elshani, neurokirurgë të tjerë, si dhe me mbështetjen e ekipit të anestezionit nga Klinikë e Anesteziologjisë si dhe monitorimin neurologjik nga dr. Melihate Pushka. Kjo metodë inovative aplikohet te pacientët të cilët, pavarësisht përdorimit të dy ose më shumë medikamenteve antiepileptike, vazhdojnë të kenë kriza të shpeshta dhe të rënda. Trajtimi me VNS konsiston në implantimin e një pajisjeje që generon impulse elektrike në nervin Vagus, duke ndihmuar në kontrollin më efektiv të krizave

epileptike. Ky shërbim i ri është rezultat i përgatitjeve shumëdimensional që kanë filluar që nga viti 2022 nga Klinika e Neurologjisë, përfshirë trajnime profesionale brenda dhe jashtë vendit (Kroaci, Belgjikë, Çeki), si dhe përpilimin e dokumentacionit dhe planit të veprimit nga grupi punues i Ministrisë së Shëndetësisë. Kjo arritje shënon një hap të madh drejt avancimit të shërbimeve neurologjike në Kosovë, duke i dhënë fund nevojës që pacientët të kërkojnë trajtim jashtë vendit, me kosto të larta dhe me barrë për buxhetin e shtetit dhe familjet e pacientëve.

140 MILIONË EURO BARRË MBI KOMUNAT, IBRAHIMI: MOSZBATIMI I AKTGJYKIMIT TË KUSHTETUESES DO TË SJELLË PASOJA KATASTROFALE

PRISHTINË, 3 QERSHOR - Komunat e Kosovës po përballen me rreziqe të mëdha financiare si pasojë e moszbatimit të aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese nr. KO79/23 nga Kuvendi i Kosovës. Ky aktgjykim shpalli jokushtetues nenin 6, paragrafin 6 të Ligjit për Pagat në Sektorin Publik, i cili përcaktonte një normë të papranueshme për punonjësit civilë. Kryetari i Asociacionit të Komunave të Kosovës, Sazan Ibrahim, ka thënë për “Telegraf”-in se megjithëse Gjykata Kushtetuese kërkoi

ndryshimin e këtij neni deri më 1 gusht 2024, Kuvendi nuk ka ndërmarrë asnjë veprim konkret për ta ndryshuar atë. Ai tha se, si pasojë, disa komuna kanë filluar të pranojnë vendime gjyqësore që i obligojnë për kompensime bazuar në një dispozitë tashmë të rrëzuar si jokushtetuese. “Ky dëm buxhetor vjen përveç një barrë tjetër të rëndë financiare që tashmë rëndon mbi komunat për shkak të zbatimit të vendimeve që burojnë nga kontrata kolektive në sektorin publik, me një kosto të vlerësuar



mbi 140 milionë euro në komunat tona”, tha Ibrahim. Ibrahim shtoi se nëse vazhdon kjo qasje e papërgjegjshme nga institucionet qendrore, komunat rrezikojnë të përballen me pasoja të dyfishta. “Nga njëra anë, me implikime financiare të paarsyeshme nga një dispozitë ligjore jokushtetuese për të cilën ato nuk kanë asnjë përgjegjësi; dhe nga ana tjetër, me barrën akumulative të detyrimeve nga kontratat kolektive që po përthithin një pjesë të konsiderueshme të buxheteve lokale. Ky zhvillim mund të

ndikojë direkt në aftësinë e komunave për të realizuar investimet kapitale, për të ofruar shërbime cilësore për qytetarët dhe për të ruajtur stabilitetin buxhetor”, u shpreh kryetari i AKK-së. Për t'i shmangur këto pasoja, Ibrahim tha se është e domosdoshme të ndërmerren qëndrime institucionale të unifikuara kundër këtij diskriminimi financiar dhe të kërkohet me forcë që përgjegjësitë të mbeten aty ku ligjërisht dhe kushtetueshëm u takojnë, pra në nivelin qendror.

NËNA ZAHIDE, NËNA QË KURRË NUK U LODH DUKE PËRKUNDUR LIRINË

Shkruan: Fadil NURA, kryetar i Komunës së Skenderajt

Në ditën e lirisë, më 18 qershor 2025, në oborrin e çerdhes që mban me nder emrin e saj, do të përkulemi, jo thjesht para një skulpture, por para një shpirti që rrezaton përjetësi. Para një gruaje që nuk ishte vetëm nënë e fëmijëve të saj, por u bë Nëna e një kombi. Nëna Zahide Jashari - simbol i qëndresës, i dhembjes, i dashurisë dhe i sakrificës së shenjtë. Kjo skulpturë që do merr dritën e ditës në oborrin e çerdhes që mban emrin e saj, është shumë më tepër se një përmendore. Është një përjetësim i dashurisë më të madhe: dashurisë së nënës për fëmijën, dhe

dashurisë së një kombi për lirinë. Nëna Zahide, me sytë plot dhimbje dhe krenari, qëndron e palëkundur pranë djepit. Përkundja e djepit është më shumë se një veprim i zakonshëm; ajo është një gjest i dashurisë, i besimit dhe i mbrojtjes, një reflektim i një lidhjeje që është e thellë, e pavdekshme dhe e papërshkrueshme. Ajo përkund jo vetëm trupin e një fëmije, por ëndrrën për liri. Me një dorë mbi djep dhe me tjetrën mbi gjurin e saj, ajo na kujton se heronjtë nuk lindin rastësisht - ato rriten nga duart dhe zemrat e nënave te tilla. Skulptura e Nënës Zahide është një fjalë pa zë që flet shumë. Është një homazh për të gjitha nënat shqiptare, por edhe një

thirrje për ne, që të mos harrojmë se liria që gëzojmë sot, ka ardhur nga djepi i përkundur me duar që nuk u lodhën kurrë së dashuruari atdheun. Me vendosjen e kësaj skulpture, ne nuk po ngremë vetëm një monument prej bronzi, por po e ngulisim në kujtesën tonë të përbashkët një simbol të përjetshëm të sakrificës, guximit dhe dashurisë së pakushtëzuar për atdheun. Nëna Zahide nuk ishte vetëm nënë e Adem e Hamëz Jasharit. Ajo ishte nëna e një ushtrie të tërë zemrash që rrahën për atdheun. Në këtë hapësirë ku rriten fëmijët dhe fillojnë të mësojnë edhe për dashurinë ndaj atdheut, do të qëndrojë një nënë heroinë që ju ruan, ju buzëqesh, dhe ju bekon - Nëna Zahide.



NISIN “DITËT E HISTORISË” PAK PARA PËRVJETORIT TË ÇLIRIMIT

EPOKA ERE Qendresa RAMA

PRISHTINË, 3 QERSHOR - Në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Prishtinës u hapën zyrtarisht “Ditët e Historisë” gjatë të cilave do të zhvillohen aktivitete që lidhen kryesisht me të kaluarën e dhimbshme dhe të lavdishme të Kosovës. Në ngjarjen e organizuar nga Departamenti i Historisë, rektori Arben Hajrullahu tha se “nëse nuk e dimë historinë, nuk e dimë as të tanishmen dhe do ta kemi të vështirë të orientohejmë në të ardhmen”. “Historia na ndihmon ta njohim



vetveten. Pa e njohur vetveten do ta kemi shumë problem edhe t'i njohim të tjerët”, ka deklaruar

Hajrullahu. Dekani i Fakultetit Filozofik, Bekim Baliqi, ka thënë se

“historia na mëson të reflektojmë rreth së kaluarës, në mënyrë që të mos i përsërisim gabimet”. “Historia është një orientim, një busull për një shtet e një shoqëri”, shpjegoi Baliqi. Udhëheqësi i Departamentit të Historisë, Mentor Hasani, në fjalimin e tij e vlerësoi historinë si dije dhe përgjegjësi. Tha se kjo disiplinë shkencore në Kosovë është e lidhur me drejtësinë dhe lirinë. Më pas, për herë të parë sivjet, bursistëve të Departamentit të Historisë iu dha çmimi “Rrustem Hyseni - ‘Historiani’” për ta nderuar absolventin e këtij departamenti, ushtarin e

UÇK-së dhe heroin e Kosovës. Gjatë “Ditëve të Historisë”, nga 2 deri më 5 qershor 2025, do të shikohet filmi dokumentar për luftën në Kosovë me titullin “Lugina” (The Walley), do të bëhen vizita në vendet e masakrave të popullsisë civile gjatë viteve 1998-1999 dhe do të organizohet tryeza e bashkëbisedimit me studentë për 26-vjetorin e çlirimit të Kosovës. Gjithashtu, në kuadër të këtyre ditëve do të ndodhë ceremonia e diplomimit të absolventëve të Fakultetit Filozofik dhe do të ketë takime me ish-studentët e shkëlqyeshëm të Departamentit të Historisë.

OSMANI NDEROHET ME MEDALJEN PËR SHËRBBIM BESNIK DHE MERITOR NDAJ ATDHEUT NGA GUVERNATORI I ANTIGUAS DHE BARBUDAS

EPOKA ERE Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 3 QERSHOR - Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, është nderuar me medaljen prestigjioze “Faithful and Meritorious Medal for Service to Country” (Medalja për Shërbim Besnik dhe Meritor ndaj Vëndit) nga guvernatori i Përgjithshëm i Antiguas dhe Barbudas, Sir Dr. Rodney Williams, sipas autorizimit nga Mbreti Charles III. Kreu i Shtetit të Antiguas dhe Barbudas ka deklaruar se kjo medalje e lartë shtetërore i është dhënë presidentes Osmani në shenjë mirënjohjeje për

leadershipin e saj të guximshëm, kontributin e jashtëzakonshëm për paqen, demokracinë dhe avancimin e rolit të grave në udhëheqje, si dhe për përkushtimin e saj të palëkundur në forcimin e marrëdhënieve ndërkombëtare. Në fjalimin e tij të posaçëm gjatë darkës së organizuar mbrëmë për zyrtarët e lartë të shteteve pjesëmarrëse në Forumin për Gratë Paqen dhe Sigurinë, guvernatori i përgjithshëm Sir Rodney Williams e cilësoi presidenten Osmani “shembull frymëzues i udhëheqjes bashkëkohore dhe një zë i palëkundur për drejtësinë dhe barazinë në skenën



ndërkombëtare”. Ai theksoi se “vizioni dhe integriteti i presidentes Osmani kanë kaluar kufijtë e shtetit të saj,

duke prekur zemrat dhe ndërgjegjen e shumë njerëzve në të gjithë botën, sidomos grave dhe vajzave”.

Presidentja Osmani e cilësoi këtë dekoratë si një nder të jashtëzakonshëm për të gjithë qytetarët e Kosovës. “Kjo dekoratë është për popullin tim i cili ka qëndruar gjithmonë me dinjitet dhe vendosmëri në mbrojtje të lirisë”, ka deklaruar presidentja Osmani gjatë pranimit të Medaljes. Medalja Zyrtare e Shquar për Shërbim Besnik dhe të Merituar ndaj Atdheut përfaqëson një nga dekoratat më të larta shtetërore të Antigua dhe Barbuda, që u jepet personaliteteve me merita të veçanta në shërbim të vëndit të tyre dhe me ndikim të dukshëm në përparimin e vlerave universale.

DËSHTIMI I HEKURUDHËS: KOSTO TË LARTA, REZULTATE TË PAKTA



PRISHTINË, 3 QERSHOR - Nga viti 2010 deri më 2017 Valon Aliu nga fshati Kojskë, komuna e Lipjanit, udhëtonte çdo ditë me tren. Fillimisht, për t'i ndjekur mësimet në shkollën e mesme në Lipjan, më pas për t'i vazhduar studimet në Fakultetin Ekonomik të Universitetit të Prishtinës (UP). Ai tregon se treni ka qenë i vetmi mjet transporti publik në fshatin e tij. “Fshati ynë është më pak se 10 kilometra larg nga qyteti i Lipjanit dhe nuk ka linjë autobusi. Treni vinte tri herë në ditë, stacionin e kam pasur afër dhe vazhdimisht e kam shfrytëzuar për udhëtim. Ishte deri në 30 për qind më i lirë krahasuar me mjetet e tjera”, thotë ky 30-vjeçar. Por, në vitin 2020, gjithçka ndryshoi. Qarkullimi i trenit u ndërpre dhe, bashkë me të, edhe mundësia për transport publik. Në mungesë të alternativave, Valoni u detyrua të blejë një veturë për të shkuar çdo ditë në vendin e tij të punës - në një bankë komerciale në Lipjan. Megjithatë, shpresa për rikthimin e trenit mbetet e gjallë. “Në momentin që treni të jetë sërish funksional, do të vazhdoj të udhëtoj me të. Ka shumë arsye për këtë: është një udhëtim komod, i sigurt, më ekonomik dhe më i shpejtë. Arrin gjithmonë në kohë”, thotë ai për Radion Evropa e Lirë (REL).

Pse u ndal treni?

Linja Fushë Kosovë - Hani i Elezit, që kalon përmes disa fshatrave të Lipjanit dhe që e përdorte Valoni, është ndërprerë për shkak të modernizimit të hekurudhave. Kjo linjë është pjesë e të ashtuquajturës Linja 10 hekurudhore, me gjatësi prej 149 kilometrash, që përfshin segmentet: Fushë Kosovë - Hani i Elezit, në kufi me Maqedoninë e Veriut, dhe Fushë Kosovë - Mitrovicë - Leshak, në kufi me Serbinë. Të dy segmentet ndërkufitare janë aktualisht jashtë funksionit. Ky është rrjeti i vetëm që e lidh Kosovën me vendet e Ballkanit Perëndimor. Punimet për rehabilitimin e kësaj linje nisën në vitin 2019, ndërsa qeveria e atëhershme pati premtuar se ato do të përfundonin në vitin 2021. Por, as tash, në vitin 2025, kjo linjë nuk është afër përfundimit. Dhe, sipas një raporti të Zyrës Kombëtare të Auditimit (ZKA), është e pamundur të përfundojë as në vitin 2027, për shkak të zgjatjes së afateve nga autoritetet përgjegjëse.

Çfarë thotë raporti i Auditimit?

Në raportin e publikuar në marsin e 2025-s për projektin

“Rehabilitimi i linjës 10 hekurudhore Hani i Elezit - Leshak”, ZKA-ja tregon se marrëveshja financiare për këtë projekt ishte ratifikuar në Kuvendin e Kosovës në vitin 2016, ndërsa kontrata e parë për punime u nënshkrua më 2019. Por, deri më tani janë përfunduar vetëm 60 për qind e fazës së parë (Fushë Kosovë - Hani i Elezit), 32 për qind e fazës së dytë (Fushë Kosovë - Mitrovicë), kurse faza e tretë (Mitrovicë - Leshak) nuk ka nisur ende. Ndërkohë, ndërtimi i 14 urave metalike, që ishte paraparë fillimisht, është hequr nga kontrata. Shkaqet për vonesat, sipas ZKA-së, janë: komunikimi i dobët ndërmjet palëve, mungesa e ekspertëve në terren, ndryshimet e shpeshta të kontratave, si dhe kërkesat për financime shtesë. Megjithëse afati i përfundimit është shtyrë deri në vitin 2027, sipas ZKA-së, ritmi aktual i punimeve lë pak hapësirë për optimizëm. Deri më tash janë shpenzuar 92.3 milionë euro nga 250 milionë sa është vlera e projektit, i cili financohet përmes kredive dhe granteve ndërkombëtare. Kompania italiane, Generale Costruzioni Ferroviarie (GCF), është kontraktuar nga Infrastruktura e Hekurudhave të Kosovës (Infrakos) për të realizuar punimet, ndërsa janë

përfshirë edhe nënkontraktorë vendorë. Infrakos, që operon në kuadër të Ministrisë së Ekonomisë, nuk iu përgjigj pyetjeve të REL-it për shkaqet e vonesave, por në letërën e konfirmimit ndaj ZKA-së është shprehur se “pajtohet me gjetjet dhe rekomandimet e raportit.” Edhe Ministria e Ekonomisë është përgjigjur në të njëjtën mënyrë. Aktualisht, linja e vetme funksionale është ajo ndërmjet Prishtinës dhe Pejës, me trenat tashmë të vjetruar.

“Mungesa e vullnetit politik po e mban Kosovën pa hekurudha”

Sadullah Avdiu, inxhinier në pension dhe ish-profesor i Projektimit të Hekurudhave në Fakultetin e Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës të UP-së, thotë se 17 vjet pas pavarësisë, është e paimagjinueshme që Kosova nuk ka arritur të funksionalizojë sistemin hekurudhor. “Po të ekzistonte vullneti, mjetet janë. Që gati dhjetë vjet është marrë kredia - ka edhe grante. Por, nuk e kanë prioritet dhe nuk e kuptojnë rëndësinë e hekurudhave”, thekson Avdiu. Sipas Avdiut, mungesa e rrjetit hekurudhor ka rënduar trafikun rrugor, ka sjellë vonesa dhe ka shtuar aksidentet.

Ai thekson se pas liberalizimit të vizave për në zonën Schengen, më 1 janar 2024, krijimi i një lidhjeje të mirë hekurudhore me vendet e Bashkimit Evropian (BE) është edhe më i domosdoshëm. “Prej kësaj periudhe është rritur fluksi i udhëtimeve drejt BE-së, dhe udhëtimi me tren do të ishte alternativa e duhur dhe me kosto më të ulët, për studentë, punëtorë sezonalë apo edhe familjarë që vizitojnë të afërmit e tyre”, tha ai për REL-in.

Hekurudha Kosovë - Shqipëri

Edhe pse linja e vjetër nuk është përfunduar, Kosova tashmë synon të lidhet përmes një hekurudhe të re me Shqipërinë. Më 15 prill, në Shqipëri u publikua projekti i linjës hekurudhore Durrës - Prishtinë, e cila parashihet të kalojë nga Shkodra, në Gjakovë dhe në fund në Prishtinë. Sipas studimit të përbashkët të fizibilitetit, kjo linjë do të jetë 105 kilometra e gjatë, me 14 tunele dhe shtatë stacione, ndërsa kostoja e përgjithshme llogaritet mbi 1.8 miliard euro. Ministria e Infrastrukturës e Kosovës nuk iu përgjigj pyetjes së REL-it lidhur me atë sa kilometra do të jenë në territorin kosovar, dhe se cila është kostoja që do të mbulohet nga Qeveria e Kosovës.

NË 26-VJETORIN E RËNIES SË DËSHMORIT XHEMAJL RAMAJ - HERO I KOSOVËS

LUFTËTARËT E MËDHENJ BIEN NË BETEJËN E FUNDIT

(Xhemajl Ramaj në kujtimet e mia)

Arben VESELAJ

Xhemajl Ramajn e mbaj mend që nga fëmijëria e hershme në Reqan. Ndonëse ka qenë dy gjenerata pra meje mbaj mend se shoqëroheshim dhe luanim bashkë qysh në ditët e para të shkollës fillore. Shoqëroheshim jo vetëm në shkollë por edhe kur i kullosnim bagëtitë lëndinave të Biraçit. Ishte koha kur argëtimin e gjenim më shumë në lojëra çobanësh, e rrallë te loja e futbollit, sepse topi për ne ishte një rekuizitë e shtrenjtë. Sigurisht, për ne fëmijët e Reqanit piku i kënaqësisë ishin tre muajt e pushimeve verore të cilat i kalonim te pusët e Buçallës. Buçalla ka qenë mrekullia e Reqanit. Për tre muaj të verës vorbullla e pusit të Buçallës shndërrohej në një lloj arene ku sprovoheshin shkathtësitë e secilit prej nesh: noti, zhytja dhe mbajtja e frymës. Xhemajli ka qenë gjithmonë i pandashëm nga Bashkimi (djali i xhaxhait të tij). Ata kudo ishin bashkë, sikur të ishin vëllezër binjakë. Xhemajli ka qenë shumë i urtë. E karakterizonte një qetësi e brendshme; gjithmonë dukej i buzëqeshur; edhe nëse ishe i ngrysur disi ta ngjiste gazin prej së largu. Shkolla fillore në Reqan atëkohë bëhej deri në klasën e katërt, në të pestën shkonim në Suharekë. Kohën më të madhe ne fëmijët e kalonim duke ecur këmbë: 3.5 km në të shkuar dhe po aq në të kthyer. Kanë qenë ato vitet e revoltave politike të pas - '81-shit, fryma e të cilave krejt natyrshëm pati reflektuar edhe te ne fëmijët. Një mëngjes, ndërsa po shkonim në shkollë, muret e shtëpive përkaj rrugës zbardhën me parulla të mëdha: “Kosova Republikë”, “Republikë, kushtetutë, ja me hatër, ja me luftë”! etj. Me të hyrë viti 1989 filluan trazirat e mëdha politike; ato morën hov sidomos pas suspendimit të autonomisë së Kosovës më 28 mars të vitit 1989. Rënia e Mustafë Veselajt në krye të demonstratës së 27 marsit të atij viti në Prishtinë ngjalli te ne jo vetëm revoltë por dhe një lloj frymëzimi atdhetar të cilin s’e kishim njohur më parë. Duhet të ketë qenë vitit 1990 kur Xhemajli i kishte regjistruar studimet në Shkollën e Lartë Pedagogjike në Prishtinë. Në atë kohë me studime në Prishtinë ishte edhe vëllai im, Fatmiri, ndërsa unë isha në shkollë të mesme në

Prizren. Një ditë nëntori me shi e takova Xhemajlin te stacioni autobusëve në Suharekë. Ai po shkonte në Prishtinë për t’i ndjekur ligjëratat, ndërsa unë për vizitë te vëllai, Fatmiri. Rrugën nga Suhareka deri në Prishtinë e bëmë bashkë. Mbaj mend se kemi llafosur gjatë; më pati rrëfyer se lexonte dhe shpërndante materiale propagandistike të organizatave politike ilegale. Kur zbritëm nga autobusi në Prishtinë (te Rrethi i Spitalit) nxori nga çanta revistën politike “Alternativa nr. 5” dhe ma dha. Që nga ajo kohë e dija se Xhemajl Ramaj ishte në kontakt me organizatat atdhetare që vepronin në ilegalitet. Këtë fakt ma kishte konfirmuar edhe pas dy vitesh, më 1992, mbasi ishte kthyer nga Zvicra, ku kishte qëndruar për një kohë. Atëbotë më kishte treguar se në Zvicër ishte inkadruar në Lëvizjen Popullore për Republikën e Kosovës (LPRK). Vitet ‘90-të për brezin tonë kanë qenë shumë të vështira. Edhe pse perspektiva për ne të rinjtë ishte krejtësisht e pashpresë, çuditërisht ishim entuziastë e optimistë për gjithçka. E dinim se regjimi i shtetit serb, i cili na mohonte çdo të drejtë jo vetëm kombëtare por edhe njerëzore, një ditë do ta kishte fundin. E, fundi i Serbisë në Kosovë, besonim ne, ishte lufta e pashmangshme. Me të shpërthyer kryengritja e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) në Drenicë, sidomos pas luftës së Jasharajve të Prekazit, më 5, 6 dhe 7 mars të vitit 1998, ne të rinjtë e Reqanit filluam të mendonim se si të mobilizoheshim. Gjatë demonstratave të njohura “Drenicë jemi me ju”, që u mbajtën në Suharekë në mars dhe prill të vitit 1998, shpesh jam takuar me Xhemajlin dhe Bashkimin. Ishim aq të revoltuar saqë mezi prisnim të gjenim rastin e parë që t’i bashkoheshim UÇK-së. Me të dalë nësitet e para të UÇK-së në Budakovë, në qershor të vitit 1998, nuk vonoi shumë dhe ne - një grup të rinjsh të Reqanit (Maliq Hasanaj, Sami Hasanaj, Xhemajl Ramaj, Bashkim Ramaj, Vahid Veselaj, Eqerem Hysenaj, Fahri Veselaj dhe unë), u takuam një mbrëmje korriku në odën e Ibrahim Veselajt dhe aty kemi vendosur që t’i bashkoheshim njësiteve të UÇK-së. Të nesërmen, kur kemi mbërri në Budakovë, ne u rekrutuam si skuadër e organizuar, të cilën e mori ta komandonte Rifat



Xhemjal Ramaj (Budakovë 1999)

Hysenaj. Skuadra jonë i gjeti në Budakovë edhe shumë të rinj tjerë të Reqanit që ishin bashkuar me UÇK-në disa ditë apo javë para nesh, si: Bujar Veselaj, Qenan Veselaj, Qamil Veselaj, Tahir Veselaj, Azem Fetaj, Bejtullah Fetaj, e ndonjë tjetër. Ibrahim Veselaj u mor me sigurimin e armëve. Në koordinim me komandën Batalionit pas pak ditësh ai na solli nga një pushkë automatike AK-47. Ne, skuadra e Reqanit, menjëherë u sistemua në atë që quhej Pika 2, në Krushicë - një llogore e gjatë dhe e fortifikuar që e ndërpriste rrugën nga Mohlani për në Budakovë. Mbaj mend se që në

ditët e para Maliqi dhe Samiu u transferuan në njësitin e Haqif Kadriajt (te Kodrojt), kurse në Pikën 2 mbetem: Eqeremi, Vahidi, Xhemajli, Bashkimi dhe unë. Gjatë asaj kohe ne ishim të sistemuar në shtëpinë Bajram Sallaukës që shërbente si kazermë, ndërsa ndërrimet në llogore i mbanim nga 6 orë. Ishte hera e parë që po përballeshim me armët. Për pak ditë u mësua edhe me ndjenjën e luftës, sepse s’vanoi dhe nisën granatimet e njëpasnjëshme, të cilat nuk u ndalën pothuajse asnjëherë, derisa arritën kulmin në ofensivën e madhe të 27 shtatorit të atij viti. U bëmë disa luftëtarë të çuditshëm: e

shpallëm fitoren ende pa filluar mirë lufta! Gjatë asaj kohe unë e njoha Xhemajlin e vërtetë; ia njoha karakterin e tij, idealet, urtësinë, trimërinë e bujarinë. Zgjoheshim bashkë çdo mëngjes dhe bashkë binim çdo mbrëmje të vonë. Gjatë orëve të rojës në llogore kishim mundësi të llafosnim gjatë. Për çka s’flisnim, se!? Temat më të preferuara të bisedave tona ishin ato politike. Për shumë gjëra pajtoheshim, por kishte disa të tjera për të cilat nuk pajtoheshim. Mbi të gjitha pajtoheshim se lufta jonë, sado që do të kishte kosto të lartë, në fund do të triumfonte. Besonim

se fitorja jonë nuk matej me aq sa herë rrëzoheshim, por me aq sa herë arrinim të ngriheshim. Besonim gjithashtu se liria ishte një e drejtë e rezervuar për të gjithë ata që ishin të gatshëm ta paguanin me kokë. Besonim me njëfarë singleriteti naiv se liria na takonte për shkakun se guxonim të ëndërronim për të.

Aty nga mesi i muajit gusht të vitit 1998 ushtria serbe nisi një ofensivë të ashpër nga Qafa e Duhlës në drejtim të pozicioneve të UÇK-së në Grejgevc e Llanisht. Nga komanda e Batalionit II ra kushtrimi për vullnetarë, të cilët do të duhej t’u shkonin si mbështetje njësiteve të Komandat Gurit. Xhemajl Ramaj qe ndër të parët që u paraqit. “Ne kemi dalë për të luftuar, s’ka kuptim të rrimë në Krushicë, ndërsa bëhet luftë në Qafë të Duhles”, thoshte ai, me një lloj padurimi për të shkuar në luftë. Mbaj mend se vullnetarë dolën Xhemajl Ramaj, Azem Fetaj, Eqrem Hysenaj ... ndoshta edhe ndonjë tjetër që tani nuk po më kujtohet.

Gjatë gjithë kohës së luftës, krahas pushkës dhe gjoksore së municionit, unë mbaja edhe një çantë sanitare me një kasetë kirurgjike, e brenda saj edhe ndonjë libër e fletore. Sapo gjeja një mundësi të vogël shmangesha dhe lexoja, në të rrallë edhe shkruaja. Kjo i bënte shumë përshtypje Xhemajl Ramajt. Ndërsa të tjerët nuk e kishin problem që nganjëherë edhe të më shpotisnin, Xhema u kundërvijei ashpër: herë si për shaka, e ndonjëherë edhe me gjithë mend, thoshte se, nëse të gjithë duhej të vriteshin në luftë, unë duhej të shpëtoja me patjetër. “Me bo me u vra Beni, kush ka me tregue për luftën tonë”?, thoshte ai.

Xhemajl Ramaj u mësua me luftën me shpejt se të gjithë ne. Ai e pranonte rënien në luftë disi si të natyrshme. Shprehte keqardhje për pleqtë dhe fëmijët që po vuanin, kurse për ne që e kishim pranuar luftën si të vetmen alternativë, thoshte: “Na duhet me dekë”! Gjatë bisedave tona të gjata shpesh thoshte se ishim brez me fat, sepse ishim protagonistë të lirisë dhe të shtetit të Kosovës. Sot kur i kujtoj ato biseda çuditëm dhe mburrem se sa vizionarë kemi qenë. Besoj se Xhemajl Ramaj, sikurse edhe shumica prej nesh, shkoi në luftë duke besuar në filozofinë se “fiton ai që di kur të luftojë”!

Tri ditë para ofensivës së madhe që ndërmori ushtria serbe më 27 shtator të vitit 1998, në njësitet tona shumë herë pati rënë alarmi për gjendje gatishmërie. Më datën 24 shtator qenë zhvilluar luftime ballë për ballë në Pikën 1, e cila ndodhej jo më shumë se 200 metra larg nesh. Aty patën mbetur të plagosur disa nga shokët tanë. Sa herë që jepej alarmi për gjendje gatishmërie Xhemajl Ramaj



Xhemajl Ramaj e Vahid Veselaj, në Budakovë më 1999

ishte i pari nga ne që brofte dhe vraponte të zinte pozicion. Rruga që e bënim prej lagjes së Sallaukëve e deri te pozicionet e luftimit në Pikën 2 shpesh ishte cak i granatimeve të artilerisë serbe e cila qëllonte prej maleve të Biraçit. Por, Xhema nuk e honepste dot rrezikun, edhe nëse ndonjëherë i shpërthente ndonjë granatë në afërsi.

Dita e ofensivës së 27 shtatorit 1998 ka qenë shumë e vështirë për ne. Alarmi ra në orët e hershme të mëngjesit. Që pa zbardhur drita ne zumë pozicionet në Pikën 2. Kur ora ra fiks në 7 nisi stuhia e bombardimeve. Intensiteti ishte aq i madh sa ne nuk kishim mundësi as ta ngrehnim kokën mbi transhetë prej dheu. Bombat na binin shumë afër saqë dheu që trazohej na binte rëndë në shpinë. Kishim urdhër që të qëndronim në pozicione dhe të hapnim zjarr vetëm kur të mbërrinte këmbësoria ose makineria lëvizëse e forcave serbe. Por kjo nuk po ndodhte. Ata nuk po vinin në këmbë. Donin të na shfarosnin nga larg. Në të rrallë, njëri prej nesh shtinte me një mitraloz diskor (DP-28) në drejtim të rrugës së asfaltuar që ndodhej poshtë llogores ndonja 200 ose 300 metra, por pa efekt. Aty rreth orës 11 intensiteti dhe koordinatat e bombardimeve sakaq ndryshuan. Nisën të na sulmonin me predha parabolike të minahedhësve. Bombat nisën të binin edhe brenda llogores sonë. Në atë situatë ne u urdhëruam të futeshim nëpër bunkerët brenda transhesë. Bombardimet nisën të bëheshin aq të rënda saqë dheu nga sipër bunkerit nisi të shembej. Currila dheu zunë të na binin mbi kokat tona. Fytyrat na u bënë meit nga dheu i zi. Mbaj mend se, të strukur, ashtu siç ishim, e

vidhnim njëri-tjetrin me sy. Ishim të bindur se ai bunker që po shembej mbi ne, do të bëhej varri ynë. Çuditërisht na vinte gjumë. Agonia e bombardimeve të rënda ka zgjatur deri rreth orës 12, kur dikush nga tanët futi kokën në bunker dhe na kumtoi urdhrin e tërheqjes. Nuk e mbaj mend mirë se si kemi arritur të dilnim nga hendeku i gjatë që ishte shembur dhe mbuluar i tëri me dhé. Nga ora 12 e deri sa ka rënë terri, të këputur e të rraskapitur kemi ecur rrëpirave të Budakovës, deri sa kemi dalë në vendin e quajtur Jela në afërsi të fshatit Jezerc. Aty dikush dha urdhër që të shpërndaheshim në grupe të vogla. Tri ditë e tri net, të uritur e të pagjumë, jemi endur maleve në zonën që kapë që prej Jezercit e deri në Suharekë, pa ditur se ku të shkonim.

Siç dihet, pas ofensivës së shtatorit të vitit 1998 në Batalionin II të Brigadës 123 u krijua një situatë kaotike; ushtarët dhe njësitet ishin shpërndarë. Në Budakovë nuk kishte një komandë të strukturuar; sikush vepronte dhe gjendej ku mundte e si mundte. Pritej një thirrje për rigrumbullim, por gjërat shkonin ngadalë dhe shumëçka vonohej. Në atë situatë më së vështiri e patëm ne ushtarët, sepse nuk kishim ku të strehoheshim. Në shtëpitë tona nuk mund të shkonim, sepse familjet tona gjatë gjithë kohës ishin nën survejimin e policisë serbe. Ne, ushtarët e Reqanit, ndërkaq, e patëm edhe më të vështirë, për shkak të bazave të përhershme serbe që në atë kohë ndodheshin aty. Unë qëndrova për disa javë në Grejkoc (te nipat e mi). Mbaj mend se edhe Xhemajl Ramaj e ka pasur të vështirë atë periudhë. Familja e tij jetonte në

Suharekë, sepse shtëpinë në Reqan ia patën djegur serbët në ofensivën e 27 shtatorit. Familja e Xhemës ishte strehuar përkohësisht në shtëpinë e Gafurr Elshanit në Suharekë. Edhe vet Xhema kishte qëndruar te Elshanët për një kohë, natyrisht në ilegalitet të thellë.

Në fund të muajit dhjetor të vitit 1998 na lajmëruan se Batalioni i Budakovës kishte zënë të rigrumbullohej. Në një ditë të ftoftë fillimjanari të vitit 1999, Xhemajl Ramaj na thirri dhe u takuam në Bukosh, për t’u risistemuar sërisht në Batalionin e Budakovës. Në Bukosh u takuam: Xhemajl Ramaj, Vahid Veselaj, Qamil Veselaj dhe unë. Në Budakovë, veç shumë shokëve nga Mushtishti, Gjinovci, Sallagrazhda etj., gjetëm edhe Rexhë Buzhalën e Asllan Kadollin, si dhe kushërinjtë - Bujar e Qenan Veselaj. Rexha na sistemoi menjëherë në Togën e tij, më ekzaktësisht në skuadrat e Asllanit dhe Bujarit. Gjatë atyre muajve të ftoftë e me borë (janar dhe shkurt), veç detyrave të zakonshme që kishim (roje, vëzhgim etj.), ne patëm mundësi që t’i kryenim edhe disa stërvitje ushtarake (fizike dhe taktike) të cilat na shërbyen shumë kur nisi ofensiva.

Ofensiva e dytë serbe në Budakovë nisi sapo filluan sulmet ajrore të NATO-s, më 24 mars 1999. Në fillim luftimet nuk qenë të intensitetit të lartë, por luftime kishte pothuajse për çdo ditë. Në atë kohë mua më erdhi një urdhër për t’u transferuar me detyrë në stacionarin e ambulancës ushtarake, më saktësisht të merrja detyrën e infermierit, sepse mjeku i Batalionit kishte mbetur pa ndihmës. Mjeku (Dr. Ibish Ahmeti), i cili e dinte se unë isha infermier me përgatitje të

mesme shkollore, i kishte kërkuar Rexhë Buzhalës që të më transferonte. Kur Rexha ma kumtoi urdhrin, bëra pak zhurmë. Nuk doja të shkoja. Më duhej të ndahesha nga Xhemajli e Vahidi. Isha mësuar me ta. Ata më mbanin afër kudo dhe disi kujdeseshin për mua si për vëllanë e tyre më të vogël. Tani unë po detyrohesha t’i lija, të shkoja në një njësit tjetër, thjesht të ndahesha prej tyre! Sidoqoftë, qenë vetë Vahidi e Xhema ata që ma mbushën mendjen për ta zbatuar atë urdhër transferimi. Pas dy ditësh unë u sistemova në shërbimin shëndetësor të Batalionit të Budakovës. Për herë të parë u përballa me gjakun, plagët ... dhe me vdekjen. Shokët e luftës vinin pa pushim në ambulancë të përgjakur e të bërë copash, kryesisht nga predhat e bombardimeve që s’pranin kurrë. Mbaj mend se në njërën nga ato ditë të vështira i plagosur erdhi edhe Azem Fetaj, por për fat ai kishte marrë një plagë relativisht të lehtë në shpatull dhe sapo e mori trajtimin mjekësor menjëherë u kthye në luftime. Ai e refuzoi rekomandimin e mjekut që të pushonte për pak kohë. Pak ditë pasi kalova me shërbim në ambulancën ushtarake, edhe Xhema e Vahidi u transferuan: ata i mori Asllan Kadolli në Togën e Bukoshit. Kur shkova për t’i vizituar, pak ditë pasi ishin vendosur atje, që të dytë i pashë me disponim të mirë, sepse në Bukosh kishin gjetur një shoqëri të mirë.

Duhet të ketë qenë gjysma e parë e muajit prill kur erdhi një urdhër nga Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së, që të kryheshin sulme të befasishme dhe të koordinuara nëpër të gjitha bazat ushtarake e policore serbe. Disa orë para aksionit në



ambulancën ushtarake në Budakovë erdhën Xhema dhe Vahidi. Ata më njoftuan për planin e sulmit që do të kryhej në bazat serbe në Reqan. Sulmi ishte koordinuar në atë mënyrë që të niste fiks në orën 4 të mëngjesit, në Reqan dhe në Mohlan, përnjëherësh. Ata kërkuan nga unë që të furnizohesha nga depoja e Batalionit me municionet që më duheshin, por assesi të mos harroja ta merrje edhe çantën e ndihmës së parë me kutinë kirurgjike, sepse dikush nga ne edhe mund ta plagosej, mbase edhe të vritej. Në aksion ishin thirrur të gjithë djemtë e Reqanit që ishin nën armë. U grumbulluam në Bukosh. Aty na u bashkuan edhe disa shokë të Bukoshit dhe të Sopisë. U ndamë në tri grupe. Grupi i parë do të zbriste drejt Reqanit nga ana e Hudarevës, që të sulmonte bazën serbe nga ana e Bukoshit; Grupi i dytë të zbriste nga Zhvinat, të dilte në Gjinovishtë dhe të sulmonte në qendër të katundit, kurse Grupi i tretë ta kapërcente Rekën e Hasanit diku në Nërjaz, të ngjitej rrëzë vreshtave të Rrezines, e të dilte përmbi Kishë, për ta sulmuar bazën që ndodhej te Kthesa në hyrje të Reqanit. Mua dhe Xhemajlit na ra të shkonim me Grupin e tretë. Komandant i Grupit u caktua Xhema, ndërsa me ne erdhën: Sami Hasanaj, Sabit Hysenaj dhe Qamil Salltekaj. Mbaj mend se atë natë kemi ecur me orë të tëra pa ditur fare se cilit shteg po shkelnim. Ka qenë rrezik të binim edhe në gracka të minuara, sepse kishte pothuajse një vit që prej se serbët e kishin shndërruar Reqanin në një bazë të madhe policore e ushtarake. Xhemajl Ramaj i ka pri grupit tonë atë natë me shumë trimëri e vigjilencë. Ai i pari zuri pozicion në një hendeke në krahun veriperëndimor të Kishës, prej ku vëreheshin lëvizjet e forcave serbe poshtë te Kthesa. Hendeku në fakt kishte qenë një istikam i forcave serbe, sepse aty gjetëm gëzhoja të mitralozit dhe një batanije kamuflazh të ushtrisë serbe. Sulmin i pari e nisi Xhema. Pas tij ia krisëm edhe ne të tjerët. Harxhuam nga disa karikatorë si dhe hodhëm bomba dore. U bë shumë zhurmë aty. Më kujtohet se disa nga bombat nuk na shkrepën, por ato që u ndezën shkaktuan shpërthime aq të fuqishme sikur të qenë predha mortajash. Aksioni që realizuam atë natë qe shumë i suksesshëm. Ashtu siç ishte planifikuar, pa asnjë dëmtim nga ana jonë, çdo gjë u përmbyll në orët e para të mëngjesit. Me të zbardhë drita të gjithë u rigrumbullam në Bukosh. U ndiem të lumtur sepse ai sulm qe një shans yni i rrallë për ta dëshmuar vendosmërinë për qëndresë deri në vdekje.

Më 26 prill të vitit 1999, ndërsa po zhvilloheshin luftime të ashpër në Bukosh, në krye të detyrës kishte rënë Selim Veselaj.

Selimi kishte pak ditë që i ishte bashkuar Togës së Bukoshit. Bashkë me Selimin ishte vrarë edhe Bafti Shala nga Mushtishtit, ndërkaq ishin plagosur Qamil Veselaj dhe Asllan Kadolli. Kur ishte dhënë lajmi se Selimi e Bafitu ishin goditur, Xhemajl Ramaj, Vahid Veselaj dhe Fahri Veselaj kishin shkuar të parët për t'i tërhequr nga vija e zjarrit. Në atë kohë unë kam qenë në ambulancë duke u marrë me shumë luftëtarë të plagosur që vinin pa ndërprerë nga vijat e frontit. Dikush tha se po i sillnin dy plagosur: Qamilin dhe Asllanin. Kur dola në oborr të ambulancës e pashë Qamilin në gjendje të rënduar. E kishte zënë predha e granatës në parakrah dhe në një pjesë të krahavorit. Ndërsa ai hoqëm këmishën që e kishte gjakosur deri në bel, pamë se kishte një plagë bukur të madhe e cila na shqetësoi. Nuk ishim të sigurt nëse predha kishte arritur në brendësi për t'ia dëmtuar mushkërinë. Menjëherë u angazhuam që të gjenim një mjet transporti për ta dërguar në spitalin ushtarak në Mollopolc të Zonës së Nerodimes, sepse atje kishte një aparat rentgeni dhe kirurg, nëse ishte nevoja për operim. Qamili kishte dhimbje të mëdha dhe krah u zuri t'i nxihej. Në atë gjendje dikush me thirri të dilja në oborr të ambulancës. Kur dola pashë Xhemajlin dhe Vahidin. Ata ishin zhytur në baltë nga koka te këmbët. Dukeshin të ngrysur, aq sa mezi flisnin. Më pyetën për Qamilin. U thash se kishte një plagë, por do të mbijetonte. Kur u ktheva në dhomën e stacionarit, Qamili, mes dhembjeve të mëdha, assesi nuk po rehatohej: kërkonte nga ne që të mos e transferonim në Mollopolc, por ta mbanim në Budakovë. Mbrëmjen e 26 prillit të vitit 1999 te Palushët e Budakovës zbritën të gjithë djemtë e Reqanit që ishin nën armë për ta varrosur Selimin. Xhema dhe Vahidi, ndonëse nuk jepeshin, dukeshin më të mërzhurit. “As vëllai im, Burimi, nuk mu kish dhimtë ma shumë”, tha Xhema pasi ia kthyem shpinën varrit të Selimit.

Pas rënies së Selimit, Xhemajli dhe Vahidi vazhduan të shërbenin me detyrë në Bukosh. Kur më rastiste detyra andejpari kthehesha dhe i vizitoja. Ishte muaji maj i vitit 1999 - koha kur rezistenca jonë, edhe për kundër vullnetit të pathyeshëm, po jepte shenja lodhjeje, për shkak të mungesës së municioneve, ushqimit dhe veshmbathjes. Nisëm ta vuanim sidomos mungesën e higjienës. Mbaj mend se në njërën prej atyre vizitave Xhema m'i pati dhënë një palë pantallona xhinse sa për t'i ndërruar të mijtë që më ishin bërë droçka-droçka. Nuk i harroj kurrë ato xhinse me ngjyrë të gjelbër sepse i mbajta veshur tri ditë, derisa i pastrova e i thava pantallonat e mi të zinj. Kur ia ktheva, më tha: “O, Shog, mbaji, po ti fali!” Por, unë nuk i mora.

Vet ai nuk kishte çfarë të vishte. Një palë pantallona kamuflazh të cilët i mbante pothuajse gjatë gjithë kohës, i kishte të grisur copa-copa. Edhe sot i kam parasysh ato xhinse të shkreta, sepse përmes tyre, një muaj e gjysmë më vonë u identifikua kufoma e tij në një varrezë masive në Suharekë.

Për herë të fundit Xhemajl Ramajn e pashë në Bukosh në mbrëmjen e datës 31 maj të vitit 1999. Ndërsa bashkë me Ibish Ahmetin, Bujar Veselajn dhe Genc Dakën po bëheshim gati të niseshim për në Kabash, e takuam Xhemën tek po bënte roje te “Brija”, siç quhej në atë kohë ai pozicion yni në Bukosh. Atë mbrëmje Xhema m'u duk krejt ndryshe. I kishte qethur flokët gati në zero dhe se si ajo qethje e tij m'u bë një ogur i lig! “Pse i ke hequr flokët, o Shog, a e di se lufta po kryhet?”, i thash si në mahi. Por Xhema nuk m'u duk me humor, ashtu siç isha mësuar ta shihja gjithmonë. U ulëm dhe ndërruam pak biseda për atë kohë të shkurtër. Më tregoi se kishte marrë vesh se familja e tij kishte mbërri në Kukës, por, po ashtu dikush i kishte thënë se babai i tij (Rexhep Ramaj) ndodhej në spitalin e Kukësit. Kur mërzhitej e kishte zakon të fliste me zë të ulët. Ashtu foli edhe atë mbrëmje, aq sa mezi e dëgjova. Në të ndarë i thash që të mos merakosej se Baci Rexhë mund të ishte në spital edhe për ndonjë shqetësim fare të zakonshëm shëndetësor. Mbaj mend se i kam thënë që të kujdesej për vetën, sepse lufta i kishte orët e numëruara.

Vetëm tri ditë pas atij takimi - më 2 qershor (1999) nisi një ofensivë krejt e papritur e ushtrisë serbe në gjithë zonën tonë. Xhema e kishte marrë plagën vdekjeprurëse nën bark, gjatë përpjekjes për t'u pozicionuar pak nën lagjen e Kadojve të Bukoshit. Një snajper serb, i pozicionuar te vendi i quajtur Gurët e Hutit, e kishte qëlluar atë në mesin e një grupi prej 7 ose 8 luftëtarësh që me vrap po përpigeshin të zinin pozicion luftimi. Plumbi që e kishte kapur i kishte shkaktuar gjakderdhje të madhe dhe ia kishte shkatërruar krejtësisht sistemin e poshtëm lokomotor. Shokët e tij, Asllani e Vahidi, këmbadoras e kishin larguar nga vija e zjarrit. Afërsisht 24 orë kishte zgjatur agonia e Xhemës. Siç kanë dëshmuar më vonë shokët e atij grupi, Vahidi, Asllani, Sejdiu, Ademi, Ismeti dhe të tjerë, gjakderdhja e madhe ia kishte bërë Xhemës shumë të vështira orët e fundit të jetës - me ethe të akullta e me etje zjarr. Por, ai s'ishte dhënë. Në çastin e fundit, kur laku i rrethimit ishte ngushtuar shumë, u kishte kërkuar shokëve ta linin. “Afromani pushkën dhe një shishe me ujë, dua të vdes duke luftuar”, u kishte thënë atyre. Dhe ashtu kishte ndodhur. Pushka e Xhemës e kishte mbushur me jehonë grykën e



Xhemajl Ramaj (Budakovë 1999)


Jarugës mëngjesin e 3 qershorit të vitit 1999. Ai kishte luftuar deri në frymën e fundit. Aty e kishte mbyllur kapitullin e jetës tokësore, ashtu siç e kishin mbyllur trimat e motit që prej kohërave që s'mbahen mend. Tri ditë më vonë (më 6 qershor) unë e mora lajmin për rënien e Xhemajl Ramajt. Guri i Kepit në lagjen e Kepëve të Budakovës m'u duk se u shemb mbi mua. Më duket se lajmin e solli Izet Buzhala. Në ato çaste të pangushëlluara m'u kujtua një fjalë që e kisha lexuar në kushedi cilin libër, të kushedi cilit autor: “Luftëtarët e mëdhenj bien në betejën e fundit!” Nuk mund të besoja se ishte vrarë vetëm Xhemajli - të vrarë e mendoja edhe Vahidin, sepse ata nuk ndaheshin kurrë, ishin si dy vëllezër binjakë.

Xhemajl Ramaj e mbylli jetën e tij heroikisht vetëm pak ditë para ditës së lirisë. Trupin e pajetë të tij e kishin marrë dhe transportuar forcat serbe po atë ditë (më 3 qershor) për në Shtëpinë e Shëndetit në Suharekë. Këtë e patëm zbuluar menjëherë pas mbarimit të luftës, përmes raportit mjekoligjor që e gjetëm në Shtëpinë e Shëndetit në Suharekë. Bashkë me xhaxhanë e Xhemajlit, Jakupin, ndërmorëm pastaj një aksion kërkimi derisa e gjetëm trupin e pajetë në një varrezë në periferi të Suharekës. Një mjek boshnjak që kishte shërbyer dhunshëm gjatë luftës në Suharekë na deshifroi dokumentin e obduksionit dhe na dëfteu saktë edhe vendin ku e kishin varrosur. Nga dokumentacioni mjeko-ligjor që gjetëm në Shtëpinë e Shëndetit në Suharekë e kuptuam, ndërkaq, se Xhema, atë ditë, më 3 qershor të vitit 1999, e kishte shpërguar katërfish jetën e tij. Më

datën 18 shtator të vitit 1999 trupi i Xhemajl Ramajt është zhvarrosur nga varreza masive e Suharekës dhe të nesërmen, më 19 shtator, bashkë me 95 dëshmorët e tjerë të Brigadës 123 të Zonës Operative të Pashtrikut, është varrosur me nderimet më të larta ushtarake në Parkun e Dëshmorëve në Suharekë. Më 28 nëntor të vitit 2019, Presidentin i Republikës së Kosovës, z. Hashim Thaçi, ia ndau titullin “Hero i Kosovës”.

Xhemajli dhe Vahidi

Gjatë gjithë kohës së luftës Xhemajl Ramaj ka qenë i pandashëm nga Vahid Veselaj. Ata kudo kanë shërbyer bashkë; kanë ndarë të njëjtin istikam, të njëjtën bukë ... i kanë ndarë bashkë cigaret, këngët që shpesh i këndonin ... i kanë ndarë edhe kumtet e trishta e sihariqet e mira. Shpesh ka ndodhur që mes nesh të tjerëve të kishte ndonjëherë zënka, sepse, siç dihet, lufta natyrshëm na pati bërë më të egër e më mosdurues, por Vahidi dhe Xhemajli kurrë nuk janë zënë mes tyre. Gjatë gjithë kohës së luftës ata janë kujdesur ta ruajnë respektin dhe nderimin për njëri-tjetrin, sikur të kishin qenë vëllezër. Rënia e Xhemajlit më 3 qershor 1999 e pati goditur shumë rëndë Vahidin. Më 2 dhe 3 qershor të '99-tës Vahidi nuk kishte marrë ndonjë plagë në trup, por kishte marrë plagë të rënda në shpirtin e tij fisnik. Më duket se rënia e Xhemajlit qe bërë një traumë e pakapërcyeshme për Vahidin, sepse që nga ajo kohë shëndeti i tij mori për të keq, derisa në vitin 2009 u diagnostikua me kancer dhe vdiq pas pak muajsh, ende pa i mbushur 40 vjet.



Sulmuesi i Serbisë: Na pret atmosferë e zjarrtë ndaj Shqipërisë, por jemi gati

Serbia do të përballlet me Shqipërinë më 7 qershor në kuadër të kualifikueseve të Botërorit. Sulmuesi i serbëve,

Aleksandër Katai, tregoi këndvështrimin e tij për sfidën që do të luhet në “Arena Kombëtare”. “Na pret atmosferë

e nxehtë, por përmes shumë dueleve në klub, në Ligën e Kampionëve dhe Ligën e Evropës, thjesht jemi

përshtatur me këtë dhe në këtë drejtim nuk mund të ndikojë asgjë. Përkundrazi, secili lojtar i përshtatet një ambienti të tillë.

Më mirë se të luhet pa tifozë. Duel i mirë për t’u dëshmuar”, ka thënë Katai për uebfaqen zyrtare të Federatës së Serbisë.

Raçi dhe Rrudhani, optimistë për fitore në dy ndeshjet miqësore



“Epoka e re”

PRISHTINË, 3 QERSHOR - Përfaqësuesja e Kosovës ka zhvilluar sot stërvitjen e tretë në kuadër të përgatitjeve për dy ndeshjet miqësore të muajit qershor kundër Armenisë dhe Komoreve. Edhe kjo seancë është mbajtur në Kampin Nacional në Hajvali dhe është karakterizuar me intensitet të lartë dhe përkushtim maksimal nga të gjithë futbollistët. Përzgjedhësi Franco Foda kishte në dispozicion të gjithë futbollistët, përfshirë edhe ata që munguan në seancat paraprake, dhe ka vazhduar të punojë me ekipin në ndërtimin e filozofisë së lojës që do të aplikohet në këto dy miqësore. Stafi teknik është përqendruar në aspektet taktike dhe organizimin e lojës në të dy fazat, në mbrojtje dhe sulm. Pas

përfundimit të stërvitjes, futbollisti Ron Raçi, i cili për herë të parë është ftuar nga Foda, u shpreh i lumtur që është pjesë e Kombëtares së Kosovës. “Jam mjaft i lumtur. Ta përfaqësosh vendin tënd është një ndjenjë shumë e mirë dhe jam krenar që jam në mesin e këtyre djemve. Do ta jap maksimumin për Kombëtaren e Kosovës. Jam duke u munduar të përshtatem me ekipin dhe taktikat e trajnerit. Stërvitjet që po i bëjmë janë me intensitet mjaft të lartë dhe shpresoj të jap më të mirën nga vetja. Të dyja miqësoret që na presin duhet t’i fitojmë në mënyrë që të jemi më të motivuar për kualifikimet e Botërorit që na presin nga shtatori”, ka thënë Raçi. Kështu tha edhe Donat Rrudhani, i cili foli për rëndësinë e këtyre dy përballjeve si pjesë e përgatitjeve për ciklin kualifikues të Botërorit. “E dimë

që janë dy miqësore shumë të rëndësishme dhe duhet t’u qasemi me shumë seriozitet, duke u përgatitur maksimalisht si individë, por edhe si grup. Lojtarët e rinj i kemi pritur shumë mirë dhe besoj se janë ambientuar. Shpresoj që edhe ata do ta tregojnë potencialin e tyre në këto miqësore”, ka deklaruar ai.

Kosova do të përballlet me Armeninë më 6 qershor dhe me Komoret më 9 qershor në stadiumin “Fadil Vokrri” në Prishtinë, me të dyja ndeshjet që nisin në orën 19:00. Këto sfida do të shërbejnë si test i rëndësishëm për “Dardanët” në prag të nisjes së kualifikimeve për Kampionatin Botëror 2026, ku janë në grup me Zvicrën, Suedinë dhe Slloveninë. Seanca e radhës stërvitore është paraparë të mbahet të mërkurën, në orën 17:00, në stadiumin “Fadil Vokrri”.

SHKURT

FC Drenica fiton ndeshjen e parë finale në futsall ndaj FC Prishtina 01

FC Drenica ka marrë një fitore të rëndësishme kundër FC Prishtina 01 në ndeshjen e parë finale të Superligës së Kosovës në futsall. Takimi i zhvilluar në palestrën “Mizahir Isma” në Rahovec përfundoi me rezultatin 4-1 në favor të Drenicës. Golat për FC Drenicën u shënuan nga Drilon Haxhijaj (2), Julian Pardo dhe Jean Trujillo. Për FC Prishtina 01, Halim Selmanaj realizoi golin e vetëm në këtë sfidë.

Tashmë ekipet kanë edhe dy ndeshje të tjera për ta përcaktuar kampionin e ri të Kosovës, me Drenicën që është një fitore larg titullit. Ndeshja e dytë është planifikuar të zhvillohet më 5 qershor.

Tare synon transferimin e Modriqit

Drejtori Sportiv i Milanit, Igli Tare, po synon ta sjellë në Milano Luka Modriqin. Sigurisht nuk bëhet fjalë për një goditje topi, për një blerje të bujshme me një lëvizje me zero kosto. Luka Modriqi u përshëndet me tifozët në “Bernabeu”, ndërsa pas Botërorit për Klube do të largohet zyrtarisht nga Real Madridi. Modriqi është një tifoz i vjetër i Milanit, që nga koha kur Zvonimir Boban, idhulli i tij, mbante të veshur fanellën kuqezi. Milani nuk është një skuadër thjesht sa për ta mbyllur karrierën, për këtë është i vetëdijshëm edhe Modriqi. Në moshën 40-vjeçare ëndrra e tij për ta veshur fanellën e “djallit” mund të bëhet realitet.

Biletat për ndeshjen Shqipëri - Serbi po qarkullojnë në ‘tregun e zi’

Federata Shqiptare e Futbollit (FShF) ka njoftuar se deri në ditën e mërkurë nuk do të shpërndahen të gjitha biletat e ndeshjes Shqipëri - Serbi. Në anën tjetër, pavarësisht prej përpjekjeve të FShF-së për një proces të drejtë dhe transparent, në praktikë, biletat për këtë ndeshje po qarkullojnë edhe në tregun e zi. Në këtë treg informal biletat shiten me çmime shumë më të larta se ato zyrtare dhe shpesh pa asnjë garanci për autenticitetin e tyre. Kjo situatë krijon jo vetëm vështirësi për tifozët që duan të blejnë bileta në mënyrë ligjore dhe të sigurt, por edhe rrezikon përhapjen e mashtrimeve dhe problemeve të tjera gjatë hyrjes në stadium. Federata dhe autoritetet bëjnë apel që tifozët ta shmangin blerjen e biletave jashtë kanaleve zyrtare, për të garantuar një përvojë të sigurt dhe të rregullt në këtë event sportiv të rëndësishëm.

Bunjaku publikon listën e Kosovës U19 për grumbullimin e qershorit

PRISHTINË, 3 QERSHOR - Përzgjedhësi i Përfaqësueses së Kosovës U19, Albert Bunjaku, ka publikuar listën e futbollistëve të ftuar për grumbullimin e radhës që do të zhvillohet në muajin qershor. Në kuadër të këtij grumbullimi, Kosova U19 do të luajë dy ndeshje miqësore kundër Përfaqësueses së regionit të Saksonisë nga Gjermania. Të

dy takimet do të zhvillohen në Kampin Nacional të FFK-së në Hajvali. Orari i ndeshjeve miqësore është të mërkurën nga ora 16:00 dhe të premten në orën 11:00. Ky grumbullim dhe ndeshjet miqësore paraqesin një mundësi të mirë për përzgjedhësin Bunjaku që ta shohë nga afër formën dhe potencialin e futbollistëve të rinj

në prag të angazhimeve zyrtare të ardhshme.

Lista: L. Gutaj, I. Rexhepi, A. Sinanaj, F. Selimi, L. Salihu, E. Hasanmetaj, A. Tahirukaj, D. Lakna, V. Cena, O. Bajraktari, E. Mavriqi, G. Dushaj, E. Kasniqi, G. Hetemaj, E. Haxhiu, M. Llumnica, R. Ahmeti, A. Murati, L. Ferati, L. Jerlia, E. Hajrullahu, F. Haxhiu, A. Rrahmani.



Khaka mund të largohet nga Leverkuseni

Leverkusen, 3 qershor - Granit Khaka, mesfushori dhe kapiteni 32-vjeçar i Zvicrës, mund të largohet nga Bayer Leverkuseni para përfundimit të kontratës së tij që është valide deri në vitin 2028. Pas një sezoni të lodhshëm, ai po merr pjesë në

ndeshje me kombëtaren në Amerikën e Veriut dhe më pas ka planifikuar disa ditë pushimi, raporton gazeta zvicerane “Blick”. Megjithatë, po flitet se Khaka mund të largohet së shpejti nga Leverkuseni, edhe pse kontrata është ende në fuqi.

Po zhvillohen bisedime për transferimin e tij, por klubi i tij i fëmijërisë, Basel, nuk është në listën e klubeve që po përpiqen ta marrin. Në vend të kësaj, ka disa klube ndërkombëtare që janë të interesuar për të. Khaka ka qenë një nga lojtarët kyç të

Leverkusenit dhe kapiteni i skuadrës. Ai ka bashkëpunuar ngushtë me trajnerin Xabi Alonso i cili e ka lënë klubin. Disa lojtarë të tjerë të rëndësishëm po largohen gjithashtu, duke ndryshuar ambientin në skuadër.



‘Nuk do ta harroj kurrë’, mesazhi i presidentit të PSG-së për Messin, Mbappen dhe Neymarin

PARIS, 3 QERSHOR - Presidenti i Paris Saint-Germain, Nasser Al-Khelaifi, ka falënderuar Lionel Messin, Kylian Mbappen dhe Neymarin, ndër ish-lojtarë të tjerë, pas fitores së tyre në Ligën e Kampionëve. Parisienët siguruan një fitore 5-0 ndaj Interit në finalen e së shtunës (31 maj) në “Allianz Arena” duke realizuar një tirplete historike. Duke folur për Jim White të talkSPORT, Al-Khelaifi falënderoi të gjithë ish-lojtarët që besuan në projektin e kampionëve të Ligës 1. “Po. Para se t’i përgjigjem pyetjes suaj Jim, mendoj se po, ta thashë këtë dhe jam shumë krenar për ekipin tonë. Por, gjithashtu, do të doja t’i falënderoja të gjithë lojtarët sinqerisht, lojtarët e



parë që nënshkruam, Javier Pastore ishte në projektin tonë, ish-kapiteni ynë Thiago Silva, Ibrahimoviq, Cavani, Thiago Motta”, ka thënë Al-Khelaifi. Ai vazhdoi: “Të gjithë, sinqerisht, Di Maria, të gjithë ata lojtarë... Dhe, do të them diçka vërtet të rëndësishme,

madje edhe Neymarin, Messin, Kylian, çfarë bënë edhe ata për klubin, nuk do ta harroj kurrë. Ata ishin pjesë e suksesit, sepse ajo që është vërtet e rëndësishme të përçohet në skenë dhe të ketë këtë histori, dhe të mbërrijmë te dita e sotme...”.

Hamilton: Ferrari nuk funksionon, ndoshta faji im

BARCELONË, 3 QERSHOR - Lewis Hamiltoni nuk i kurseu fjalët pas një fundjave zhgënjyese në Barcelonë. Piloti i Ferrarit, shtatë herë kampion bote në Formula 1, e cilësoi garën në Montmelo më të keqen në karrierën e tij, duke pranuar publikisht se nuk e ka ende ndjesinë e duhur me makinën SF-25. Në kualifikime, britaniku zuri vendin e pestë, ndërsa përfundoi i gjashti në garë, përfitim ky nga një penalizim i Max Verstappenit. Por as ky rezultat nuk e zbuti frustrimin e tij. “Ishte gara më e keqe e jetës sime për sa i përket balancës së makinës. Nuk ka asgjë pozitive për të marrë me vete nga kjo fundjavë. Nuk kam asnjë ide pse kjo makinë sillet me kaq shumë luhatje. Është ndoshta më e keqja që kam drejtuar ndonjëherë”, ka thënë Hamiltoni. Në komunikimin radiofonik



gjatë garës me inxhinierin Riccardo Adami, Hamiltoni u ankua për mënyrën se si sillet SF-25 në pistë, duke theksuar pa mëdyshje se diçka nuk funksionon siç duhet. Pas garës, i pyetur nga Sky Sport UK, ai ka

shtuar: “Çfarë doni të them më shumë? Ishte një ditë e tmerrshme. Nuk kam asgjë tjetër për të shtuar. Ndoshta është faji im. Ndoshta nuk jam unë në nivelin e duhur”. Pavarësisht prej kësaj, drejtuesi i skuadrës Ferrari, FredericVasseur, u përpoq ta mbështeste Hamiltonin: “Lewis ishte për më shumë se 70 % të garës përpara Russell. Dhe nuk besoj se George e konsideron garën e tij një katastrofë. Kishim një problem në stint-in e fundit para Safety Car. Rezultati nuk është i mirë, por Hamiltoni tregoi ritëm më të mirë gjatë shumicës së kohës”. Ferrari mbetet ende në kërkim të stabilitetit, ndërsa Hamiltoni përpiqet ta gjejë harmoninë me makinën. E ardhmja do të tregojë nëse kjo fundjavë do të mbetet një moment i errët i izoluar, apo shenjë e një sezoni më të vështirë se pritej.

SHKURT

Gjimshiti pritet të transferohet në Katar

Mbrojtësi i Kombëtares së Shqipërisë, Berat Gjimshiti, sipas të gjitha gjasave, karrierën do ta vazhdojë në Katar pasi do të largohet këtë verë nga Atalanta. Bëhet me dije se Gjimshiti do t’i bashkohet skuadrës Al-Rayyan pasi thuhet se 32-vjeçari ka pranuar ofertën për t’u zhvendosur në Katar. Po ashtu, mësohet se edhe Atalanta nuk do t’i rezistojë ofertës prej gati 15 milionë eurosh për Gjimshitin, i cili ka kontratë me ekipin italian deri në vitin e ardhshëm. Thuhet se Al-Rayyan ka plotësuar të gjitha kërkesat e Gjimshitit dhe pritet së shpejti ta arrijë marrëveshjen edhe me Atalantan. Gjimshiti është pjesë e Atalantas prej vitit 2016, kurse në Itali ka luajtur edhe për Avellinon e Beneventon. Me fanellën e Atalantas, Gjimshiti sezonin e shkuar ka fituar Ligën e Evropës, kurse këtë sezon ka regjistruar 47 paraqitje në të gjitha garat, duke kontribuar me dy gola e po kaq asistime.

West Hami, favorit në garë për transferimin e Jasharit

West Ham Unitedi duket se ka lënë prapa skuadrat e tjera në garën për shërbimet e mesfushorit Ardon Jashari, raportojnë të martën mediet angleze. Mësohet se West Hami ka filluar negociatat me Club Bruggen për Jasharin, i cili pritet të largohet nga skuadra belge këtë verë. Madje West Hami është gati të ofrojë 40 milionë euro për kartonin e Jasharit, i cili po kërkohet edhe nga Manchester City, Borussia Dortmundi, Juventus, Paris Saint-Germaini e Roma. Te West Hami, Jashari po shihet si përforcim i duhur për mesfushën dhe për këtë arsye ekipi anglez po synon që sa më shpejt të arrijë marrëveshje me Bruggen. 22-vjeçari ka pasur një sezon fantastik te Brugge, ku shënoi 4 gola dhe bëri 6 asistime, kurse me skuadrën nga Belgjika ka kontratë deri në vitin 2029. Ai verën e shkuar u transferua te Brugge nga skuadra e Luzernit, ndërsa ka edhe dy paraqitje me Kombëtaren e Zvicrës.

Fernandesi refuzon ofertën e ‘çmendur’ nga Al Hilali

Bruno Fernandes e ka refuzuar ofertën e “çmendur” nga ekipi arab Al Hilal. Kapiteni i Manchester Unitedit e ka refuzuar ofertën me qëllimin që ta vazhdojë karrierën në Evropë. “Bruno Fernandes e ka refuzuar propozimin e Al-Hilalit. Pavarësisht prej kontratës së çmendur nga klubi arab, Bruno Fernandes dëshiron të vazhdojë të luajë në Evropë”, ka shkruar Fabrizio Romano. Fernandesi është i lidhur gjithashtu me një transferim te Real Madridi dhe Bayern Munichu për shkak të mungesës së futbollit evropian për sezonin 2025/2026 me Unitedin.

Kimmichi e dëshiron Wirtzin në Bayern

Mesfushori gjerman i Bayern Munchenit, Joshua Kimmich, ka thënë se do të donte që shoku i tij të bashkohej me bavarezët. “Si lojtar i Bayern Munichut që jam, do të doja që ai të kishte ardhur te ne”, ka thënë Kimmich. Ylli i Bayer Leverkusenit kërkohet nga shumë klube evropiane, por është më afër transferimit në Liverpool. Kampionët e Anglisë kanë ofruar 135 milionë për gjermanin, por Leverkuseni kërkon plus edhe 15 milionë të tjera.

Yamal: Do ta fitoj Botërorin dhe Ligën e Kampionëve

Lamine Yamal, ylli 17-vjeçar i Barcelonës, ka dhënë një intervistë të gjatë për “Cadena Ser”, ku ka folur për sezonin që e ka shpallur një nga lojtarët më të mirë në botë. I grumbulluar me përfaqësuesen spanjolle, talenti i ri ka ndarë mendimet e

tij për të ardhmen, për trofetë më të rëndësishëm dhe për vlerësimet personale të sezonit. I pyetur për objektivin e “Topit të Artë”, Yamal u shpreh i qartë: “Unë hyj në fushë, luaj dhe argëtohem. Nëse duhet të ndodhë, do të ndodhë...”. Ai

nuk e sheh këtë trofe si një obsesion, por si një shpërblim të natyrshëm të paraqitjeve të tij. Kur u pyet për preferencën në mes të Kupës së Botës dhe Ligës së Kampionëve, Yamal nuk bëri zgjedhje: “Nuk mund të zgjedh mes tyre, sepse do të

marr pjesë në të dyja, dhe do t’i fitoj të dyja”. Në lidhje me kontratën e re të nënshkruar me Barcelonën, Yamal ka thënë: “Doja ta zgjidhja çështjen sa më shpejt që të mundesha për t’u përqendruar te loja. Sapo erdhi mundësia, e nënshkrova

menjëherë”. Ai komentoi edhe finalen e Ligës së Kampionëve, ku PSG-ja mposhti Interin 5-0: “E meritoni, sepse bënë një sezon të jashtëzakonshëm. Por nuk besoj se do të përfundonte po njësoj nëse do ta luanin përsëri”.

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 16, pika 4, Kompania “Enisi” shpk Studençan- Suharekë, në bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe komunën organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për Pëlqim Mjedisor, – për Përpunimin, Thërmimin dhe Seperimin e Shkëmbinjëve Gëlqeror – Rritja e Kapaciteteve të Prodhimit, Linja 2, në Z.K. Studençan, Suharekë.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 18.07.2025 në ora 11:00 në ShFMU “Kongresi i Manastirit” Studençan, komuna e Suharekës, do të organizohet debat publik nga Kompania “Enisi” shpk Studençan- Suharekë, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe Komunën.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM

<https://us05web.zoom.us/j/7012651943?pwd=JsviMPR68pjZDwwrm2Z53eU1x9TEbu.1>

Meeting ID: 701 265 1943

Passcode: 123456

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për Kompaninë “Enisi” shpk Studençan- Suharekë, për Pëlqim Mjedisor, – për Përpunimin, Thërmimin dhe Seperimin e Shkëmbinjëve Gëlqeror – Rritja e Kapaciteteve të Prodhimit, Linja 2, në Z.K. Studençan, Suharekë.

<https://mmphi.rks-gov.net/Document/Announcements?type=2>

Në emalin e mëposhtëm mund të dërgoni komentet lidhur me projektin vn.m.komente@rks-gov.net

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon në implementimin e projektit.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “Toma Tu Caffè” SH.P.K. me seli në Prishtinë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 810144725 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “Toma Tu Caffè” D.O.O. Pristina, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 810144725 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potrazivanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability “Toma Tu Caffè” L.L.C. with headquarters Prishtinë, has come to the decision to quit its business: 810144725 the company has appointet a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.



Gjei PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjei Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook  www.facebook.com/gjeipuneshpejte

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156  +386 49 848 553

PRISHTINË

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

“Istanbul Baklava” SH.P.K. me numër Unik Identifikues: 811937955, Gjilan me pronar Avni Kamberi dhe Kasim Ivgen bënë shpallje në gazetë për zvogëlim të kapitalit nga 350.000 Euro në 170.000.

- Blerton Sefsalihu shpall të pavlefshme dëftesat e kl.10.11 të shmt “Nexhmedin Nixha” Gjakovë nga Demjani Gjakovë.

- Eriona Muhadri shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10t ë gjimnazit “Hajdar Dushi” Gjakovë.

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

- Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë nume të tel: 049-440-466.

Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.

- Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.



ROYAL CROWN

RC
cola

ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

Columbus, Georgia, USA
Since 1905

Columbus, Georgia, USA
Since 1905

MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA 1992

